

AVANCIMI I REFORMËS SË TRANSPARENCËS SË PRONËSISË SË MEDIAS NË SHQIPËRI



*Analizë e
boshllëqeve,
përafrimi me
standardet europiane
e ndërkombëtare
dhe praktikat e mira,
së bashku me një
udhërrëfyes praktik*

Avancimi i reformës së transparencës së pronësisë së medias në Shqipëri: analizë e boshllëqeve, përafrimi me standardet europiane e ndërkombëtare dhe praktikat e mira, së bashku me një udhërrëfyes praktik

Autor: Marius Dragomir

Përgjegjësia redaktuese

Pikëpamjet e shprehura në raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Tabela e lëndës

Përmbledhje ekzekutive.....	3
1. Qëllimi, fushëveprimi dhe metodat	5
2. Gjendja dhe pasqyra e tregut.....	6
2.1 Harta e tregut	6
2.2 Përmbledhje e rreziqeve sistemike	7
2.3 Harta rajonale e rreziqeve	9
3. Kuadri ligjor dhe institucional për Median	12
4. Transparenca e pronësisë së medias: praktika aktuale kundrejt standardeve europiane	14
4.1 Çfarë kërkojnë EMFA/AVMSD-ja?	14
4.2 Shqipëria sot: Vetëm transparenca nuk mjafton	15
4.3 Matrica e analizës së boshllëqeve.....	16
4.4 Rreziqet në praktikë.....	19
5. Standardet ndërkombëtare dhe qasjet europiane	20
5.1 Standardet	20
5.2 Qasjet europiane për garantimin e pluralizmit të medias	21
Gjermania (KEK): Pragjet e pjesës së audiencës fiksohen në ligj.....	21
Franca (ARCOM): Modeli strukturor i kombinuar me përmbajtjen	21
Italia (AGCOM): Matësi ndërmedial SIC dhe testi i ri “i vlerësimit të fuqisë domethënëse në treg”	22
Irlanda (Coimisiún na Meán): Rregulla mbi pronësinë dhe kontrollin të lidhura me fondet për gazetarinë... ..	23
Zvicra (OFCOM/Publicom): Matja e fuqisë së formësimit të opinionit publik	23
5.3 Çfarë na tregojnë standardet dhe qasjet e ndryshme ndaj pluralizmit mediatik	24
6. Rekomandime	25
6.1 Transparenca e pronësisë (ligjore).....	25
6.2 Masa për mbrojtjen e pluralizmit të tregut (në rrafshin e politikave)	26
7. Diskutimi mbi zbatimin	27
Faza 1: Hartimi dhe konsultimi.....	27
Faza 2: Strukturimi institucional dhe pilotimet	27
Faza 3: Intensifikimi i zbatimit.....	27
Treguesit e zbatimit të suksesshëm:.....	27
Përfundime: rreziqet, masat zbutëse dhe varësitë	28

Përmbledhje ekzekutive

Sistemi mediatik në Shqipëri ndodhet në një pikë kthese. Pas skenës dinamike dhe konkurruese fshihet një çekuilibër strukturor: një grusht transmetuesish të fuqishëm dominojnë tregun, ndërkohë që shumica e mediave online funksionojnë pa asnjë rregull. Rezultati është një treg mediatik që në sipërfaqe duket pluralist, por në brendësi mbetet i errët dhe jo transparent. Raporti i Komisionit Europian për vitin 2024 e artikuloi këtë realitet shumë drejtpërdrejtë, duke kritikuar progresin e pamjaftueshëm në transparencën e pronësisë dhe mbivendosjet e vazhdueshme mes interesave politike dhe atyre ekonomike.

Ky përfundim konfirmohet edhe nga studimi që keni në dorë. Ndërsa shumë nga sfidat e medias shqiptare - përfshirë kapjen me ligj, pasigurinë në punë dhe përqendrimin e pronësisë - janë thellësisht të ndërlikdhura, transparenca mbetet themeli mbi të cilin duhet të qëndrojnë të gjitha reformat e tjera. Pa informacion të qartë, të aksesueshëm dhe të verifikueshëm mbi pronarët dhe financuesit e mediave, asnjë masë rregullatore dhe asnjë politikë mbrojtëse nuk mund të garantojë llogaridhënie reale.

Shqipëria ka hedhur tashmë hapin e parë në këtë drejtim përmes krijimit të një regjistri të pronësisë së mediave audiovizive, por hapat pasues – zgjerimi i tij i mëtejshëm, thellimi i të dhënave dhe përdorimi i tij në përputhje me ligjin - do të përcaktojnë nëse transparenca do të shndërrohet në një parim që vepron apo do të mbetet një ushtrim formal.

Aktualisht, sistemi i ngjan një enigme ku gjysma e pjesëve mungojnë. Të dhënat e pronësisë për televizionet dhe radiot mund të jenë të disponueshme, por sektori online i cili ndodhet në rritje të vazhdueshme dhe nga i cili gjithnjë e më shumë qytetarë marrin informacionin e tyre, mbetet jashtë mbikëqyrjes zyrtare. Qindra portale operojnë në mënyrë anonime, disa si guaska tregtare, të tjerë si mjete politike ose korporative.

Po aq problematike është mungesa e transparencës lidhur me financimin publik të mediave. Paratë publike shpesh kanalizohen përmes ndërmjetësve, agjencive të marketingut ose zyrave bashkiake, pa publikimin në vijueshmëri të shumave, përfituesve apo kritereve. Mungesa e një sistemi transparent për shpërndarjen e këtyre fondeve lejon që ndikimi politik të depërtojë në vendimmarrjen editoriale, duke shpërblyer mediat konformiste dhe duke marginalizuar ato kritike. Në këtë mënyrë, financimi publik i medias mund të shndërrohet në një mjet të butë kontrolli — një mënyrë për ta përkulur tregun pa e thyer atë.

Standardet europiane janë të qarta dhe pa ekuivok në këtë drejtim. Akti Europian për Lirinë e Medias (European Media Freedom Act - EMFA), i cili hyri në fuqi në gusht 2025, vendos rregulla të qarta për deklarimin e pronësisë, transparencën e reklamave shtetërore dhe pavarësinë e rregullatorëve. Ai kërkon që të gjitha mediat të zbulojnë pronarët e tyre ligjorë dhe përfitues, të publikojnë informacion mbi burimet e financimit dhe të deklarojnë të ardhurat e marra nga burime shtetërore. Këshilli i Europës dhe OSBE-ja shkojnë edhe më tej, duke e konceptuar transparencën si një garanci demokratike, e jo thjesht si një detyrim burokratik. Në raport me këto standarde, kuadri shqiptar mbetet ende i ngushtë, i fragmentuar dhe tepër i varur nga vetëdeklarimi.

Për të kapërcyer këtë hendek, Shqipëria duhet të shkojë nga deklaratimet e pjesshme drejt një kuadri gjithëpërfshirës dhe të balancuar për transparencën. Idealisht, kjo do të kërkonte një ligj që i trajton të gjitha mediat njësoj dhe i bën deklaratimet e pronësisë dhe financimit të detyrueshme për të gjithë aktoret mediatikë, duke shmangur me kujdes çdo formë të kontrollit indirekt që do të binte ndesh me standardet e Këshillit të Europës (*shih seksionin 1: Qëllimi, Fusha e Zbatimit dhe Metodologjia*), veçanërisht në një kontekst ku shqetësimet për pavarësinë e rregullatorëve dhe klimën politike mbeten të forta.

Një kuadër i tillë duhet t'u kërkojë kompanive mediatike të publikojnë të dhënat mbi pronarët e tyre ligjorë dhe përfitues (përfshirë lidhjet familjare ose ato të përfaqësimit), lidhjet nëpërmjet kontratave dhe koncesioneve shtetërore, si dhe raportet financiare vjetore duke specifikuar burimet e të ardhurave. Megjithatë, proporcionaliteti është thelbësor: sanksionet dhe pesha e respektimit të detyrimeve nuk duhet të rëndojnë në mënyrë disproporcionale, veçanërisht mbi mediat e vogla dhe jofitimprurëse, të cilat shpesh janë më të ekspozuara ndaj presionit politik apo administrativ.

I njëjta kujdes duhet të ushtrohet edhe për transparencën e financimit publik të mediave. Është legjitime të kërkohej deklarim nga përfituesit, por një detyrim edhe më i fortë u takon autoriteteve publike që disbursojnë këto fonde. Ministrinë, bashkitë dhe ndërmarrjet shtetërore kanë detyrimin ligjor dhe etik të publikojnë në mënyrë proaktive të dhëna të detajuara mbi të gjitha pagesat, prokurimet, sponsorizimet dhe kontratat e reklamave me median, duke garantuar llogaridhënie në burim dhe jo duke ua transferuar të gjithë barrën mediave.

Po aq e rëndësishme është të përcaktohet çfarë do të konsiderohet "media". Ndërsa këtu përfshihen qartësisht aktorët tradicionalë të mediave audiovizive dhe të shtypit, për komunikimet online ekzistojnë paqartësi: a duhet të përfshihen në media edhe influencersit, podkasterët, OJQ-të lokale që menaxhojnë faqe komunitare, apo faqet satirike në Facebook me audiencë të mëdha? Satira dhe parodia, si forma të mbrojtura të shprehjes politike, për shembull, mund të kenë nevojë për garanci specifike.

Çdo regjistër i centralizuar që kombinon të dhënat mbi pronësinë dhe financimin duhet, për rrjedhojë, të administrohet nga një organ realisht i pavarur dhe të konceptohet në mënyrë të tillë që të garantojë transparencë pa imponuar kontroll të tërthortë. Përkufizimet e qarta, detyrimet proporcionale dhe garancitë procedurale janë thelbësore për të shmangur shndërrimin e këtij sistemi në një mekanizëm ndërhyrjeje politike, në vend që të shërbejë si një instrument i vërtetë i llogaridhënies publike.

Është e domosdoshme që çdo përpjekje reformuese të jetë e koordinuar, duke përfshirë jo vetëm institucionet publike si Ministria e Drejtësisë, rregullatorin e medias dhe Kuvendin, por edhe vetë komunitetin mediatik, përfshirë shoqatat e gazetarëve, përfaqësuesit e redaksive dhe *startup*-et e reja teknologjike dhe ato që bazohen në të dhëna. Procesi duhet të karakterizohet nga hapja ndaj konsultimit, transparenca dhe pjesëmarrja e vazhdueshme e aktorëve të shoqërisë civile, ekspertëve dhe organizatave profesionale.

Rezultati i synuar do të ishte një kuadër transparence i mirëkonceptuar, publik dhe i verifikueshëm. Një kuadër i tillë jo vetëm që do ta afronte Shqipërinë me standardet europiane në fushën e medias, por do të kishte edhe një ndikim më të gjerë shoqëror, duke ndihmuar në rikthimin e besimit publik. Ai do t'u mundësonte qytetarëve të shihnin se kush qëndron pas lajmeve që konsumojnë, do t'u lejonte politikëbërësve të identifikonin konfliktet e interesit, veçanërisht në mediat e mëdha audiovizive, dhe do t'u jepte mediave transparente mundësinë të konkurrojnë në kushte të ndershme. Në fund të fundit, një kuadër i tillë do të ndihmonte evolucionin e medias shqiptare drejt të qenit më pluraliste, më e pavarur dhe më e besueshme.

1. Qëllimi, fushëveprimi dhe metodat

Ky punim është porositur nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri në kuadër të projektit “Forcimi i lirisë dhe qeverisjes së medias: një qasje strategjike për zhvillimin e medias dhe komunikimit publik në Shqipëri (Faza 1)”. Studimi i përgjigjet Raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë 2024 dhe mbështet përparimin e vendit drejt anëtarësimit në BE, duke u përqendruar në një nga fushat më të ndjeshme të qeverisjes së medias: transparencën e pronësisë dhe pluralizmin e saj.

Qëllimi i këtij punimi është të ofrojë një analizë ligjore dhe politike të transparencës së pronësisë së medias në të gjitha llojet e mediave (të shkruara, televizive, radiofonike dhe online) në kontekstin shqiptar. Fusha e analizës përcaktohet nga parimet dhe angazhimet e Shqipërisë në kuadër të OSBE-së dhe nga procesi më i gjerë i integritit europian, veçanërisht reformat e nevojshme për përafrimin e kuadrit kombëtar me Aktin Europian për Lirinë e Medias (European Media Freedom Act - EMFA), Direktivën për Shërbimet Mediatike Audiovizive (AVMSD) dhe rekomandimet e Këshillit të Europës për transparencën dhe pluralizmin e medias. Gjithashtu, analiza e vendos, Shqipërinë në një perspektivë krahasuese, duke u mbështetur në mënyrë selektive në praktikën e BE-së dhe të Këshillit të Europës për të identifikuar modelet funksionale si dhe boshllëqet ekzistuese.

Studimi kombinon disa qasje metodologjike. Së pari, është analizuar legjislacioni ekzistues në Shqipëri (*desk review*), aktet nënligjore dhe rregulloret përkatëse që lidhen me pronësinë dhe transparencën e medias. Së dyti, është realizuar një vlerësim i regjistrimit të pronësisë që mbahet nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), i cili publikon deklaratimet e subjekteve të licencuara ose të autorizuara, me qëllim shqyrtimin e efektivitetit dhe plotësisë së mekanizmave aktualë të deklarimit. Së treti, punimi mbështetet në intervista me aktorë të interesuar, përfshirë gazetarë, subjekte rregullatore, përfaqësues të shoqërisë civile dhe ekspertë ligjorë, për të pasqyruar sfidat praktike të zbatimit (në total janë zhvilluar shtatë intervista për këtë raport). Së katërti, janë shqyrtuar standardet përkatëse europiane dhe ndërkombëtare, përfshirë EMFA-në, AVMSD-në dhe Rekomandimet e Këshillit të Europës (2007/2 dhe standardet e vitit 2018 mbi transparencën e medias dhe pronësinë).

Analiza mbështetet në një sërë burimesh, përfshirë Raportin e Komisionit Europian për Shqipërinë 2024, materialet dhe të dhënat e regjistrimit të AMA-s, praktikën gjyqësore përkatëse, dokumente të mëparshme analitike të OSBE-së, si dhe studimet më të fundit kërkimore mbi median shqiptare. Së bashku, këto burime synojnë të ofrojnë një pasqyrë të balancuar të kuadrit ligjor, zbatimit të tij në praktikë dhe shkallës së përafrimit të sistemit shqiptar me standardet dhe angazhimet europiane.

2. Gjendja dhe pasqyra e tregut

2.1 Harta e tregut

Tregu mediatik shqiptar paraqet një paradoks midis dendësisë dhe brishtësisë. Nga njëra anë, numri i mediave është jashtëzakonisht i lartë në raport me përmasat e vendit; nga ana tjetër, përqendrimi i pronësisë dhe mungesa e transparencës strukturore kufizojnë pluralizmin dhe deformojnë funksionimin e tregut. Katër segmentet kryesore – televizioni transmetues, radioja, OTT/VOD kabllorë dhe operatorët e lajmeve online – rregullohen në mënyrë të pabarabartë, ku kanalet që operojnë vetëm online mbeten pothuajse tërësisht jashtë kuadrit ligjor.

Televizioni mbetet mediumi dominues në ekosistemin informativ të Shqipërisë. Sipas Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), janë licencuar 34 televizione private, prej të cilave tre operojnë në nivel kombëtar, ndërsa të tjerat u shërbejnë audiencave lokale ose rajonale.¹ Krahas tyre, transmetuesi publik Radio Televizioni Shqiptar (RTSH) transmeton në disa kanale televizive dhe frekuenca radiofonike.

AMA ka licencuar, gjithashtu, 53 stacione radioje private, prej të cilave tre janë kombëtare. Radioja luan një rol relativisht të vogël si në tregun e reklamave ashtu edhe në formësimin e opinionit publik. Ka pak të dhëna të besueshme për financat apo për pjesën e tregut që zotërojnë, pasi shumica e radiove u përkasin konglomerateve më të mëdha dhe nuk publikojnë bilance të ndara. Kjo e bën të vështirë vlerësimin e përqendrimit të pronësisë, megjithëse të dhënat anekdotike sugjerojnë një shkallë të ulët diversiteti.

Televizioni me pagesë dhe segmenti i shërbimeve *streaming* në Shqipëri është i fragmentuar. AMA regjistron 66 operatorë kabllorë, shtatë operatorë IPTV, 10 shërbime OTT, dy shërbime VOD dhe dy platforma satelitore abonimi. Shpërndarja është konkurruese në nivel infrastrukture, por shumica e operatorëve kabllorë/IPTV transmetojnë në kanalet kombëtare dominante, duke forcuar më tej shtrirjen e tyre. Platformat OTT, përfshirë shërbimet rajonale dhe ndërkombëtare, janë zgjeruar ndjeshëm, megjithatë përmasa e vogël e tregut vendas kufizon qëndrueshmërinë ekonomike të nismave VOD të pavarura shqiptare.

Televizioni kabllor dhe satelitor janë subjekt i rregullimit audioviziv, por zbatimi praktik i këtij rregullimi mbetet i dobët. Detyrimet “must-carry” ekzistojnë në ligj, por zbatohen në mënyrë të paqëndrueshme, ndërsa masat për promovimin e përmbajtjeve me interes publik mbeten të pamjaftueshme.

Pjesa më dinamike, por njëkohësisht më e errët e tregut është media online. Vlerësimet sugjerojnë se në Shqipëri ekzistojnë midis 740 dhe 750 portale online,² ndonëse hartëzime të tjera, për shkak të dallimeve metodologjike, kanë identifikuar rreth 150 media aktive.³ Pavarësisht këtyre ndryshimeve, bëhet fjalë për një sektor shumë të madh dhe tejet dinamik. Ky shumim krijon përshtypjen e pluralizmit, por shpesh karakterizohet nga duplikimi i përmbajtjeve, gazetaria *copy-*

¹ Të dhënat janë marrë nga baza e të dhënave e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) (<https://ama.gov.al/oshma/>), aksesuar më 15 shtator 2025.

² Londo, I. (2025). *Our Media: Shqipëria. Civil society report on media and journalism in Shqipëria*. Tirana: SEENPM, p 13. <https://futureofmedia.seenpm.org/wp-content/uploads/2025/03/Ourmedia-Shqipëria-EN.pdf>.

³ Cukali, K. (2025). *Shqipëria Studim i Medias 2025: Hartëzimi i plotë i peizazhit*. UNESCO. <https://kshm.al/wp-content/uploads/2025/07/Mapping-2025-anglisht.pdf>

paste dhe standarde të ulëta editoriale. Ndryshe nga mediat audiovizive, platformat online nuk kanë detyrimin të regjistrohen pranë AMA-s. Shumë prej tyre ekzistojnë vetëm si biznese tregtare, OJF ose mbeten të paregjistruara, duke e bërë pothuajse të pamundur gjurmimin e pronësisë dhe financimit.

Tregu shqiptar i reklamave arriti rreth 72 milionë euro në vitin 2023, dyfishi i nivelit të vitit pandemik 2021 prej 35 milionë eurosh. Televizioni thith 76% të këtyre të ardhurave, duke nënvizuar dominimin e tij të vazhdueshëm. Media e shkruar pothuajse është zhdukur: kanë mbetur vetëm shtatë gazeta të përditshme, ndërsa shumica e botimeve javore dhe titujve rajonalë janë mbyllur. Mediat online përthithin një pjesë gjithnjë në rritje të reklamave, por kjo mbetet gjerësisht e paqartë dhe e pamatur.

Financimi publik i medias⁴ përbën një tjetër shkak madhor të deformimit të tregut. Shpërndarja e fondeve shpesh bëhet pa transparencë, duke anashkaluar procedurat e hapura të prokurimit dhe duke u kanalizuar përmes nënkontraktorëve ose agjencive të marketingut. Ky sistem është jashtëzakonisht i ekspozuar ndaj ndikimit politik, ku fondet shpesh drejtohen në mënyrë selektive drejt mediave që favorizojnë pushtetin. Problemi nuk është vetëm procedural, por edhe strukturor, pasi këto praktika shtrembërojnë konkurrencën në treg dhe ndikojnë drejtpërdrejt në pavarësinë editoriale. Zhvillimet e fundit e ilustronjë qartë këtë fenomen: për shembull, pas mbylljes dhe bllokimit operacional të News 24⁵ në gusht 2025, media u përball me presion të fortë ekonomik dhe raportoi vështirësi serioze në sigurimin e të ardhurave nga reklamat, duke reflektuar rreziqet strukturore për mediat kritike ndaj autoriteteve qeveritare.

Zbatimi i Aktit European për Lirinë e Medias (EMFA) do ta detyrojë Shqipërinë të vendosë rregulla jodiskriminuese për shpërndarjen e fondeve publike në të gjitha platformat, përfshirë mediat online. Garantimi që këto mekanizma të zbatohen në mënyrë të paanshme dhe të pavarur do të jetë thelbësor për të parandaluar shndërrimin e burimeve publike në instrumente të kontrollit politik. (shih 4.1 Kërkesat e EMFA/AVMSD)

2.2 Përmbledhje e rreziqeve sistematike

Raporti i Komisionit European 2024 për Shqipërinë⁶ theksoi rreziqe sistematike të vazhdueshme dhe të thella që vazhdojnë të minojnë pavarësinë dhe pluralizmin e mediave. Katër fusha u dalluan si veçanërisht kritike: përqendrimi i pronësisë, mbivendosja e interesave politike dhe biznesore, financimi jo transparent dhe masat e dobëta për mbrojtjen e punonjësve në sektor. Së bashku, këto rreziqe krijojnë një mjedis të brishtë ku gazetaret kanë vështirësi në përmbushjen e rolit të tyre demokratik.

⁴ Në këtë raport, do të përdorim termin “financim publik për mediat” për t’iu referuar në mënyrë të përgjithshme të gjitha burimeve financiare të kanalizuar nga institucionet publike drejt mediave — duke përfshirë jo vetëm reklamat shtetërore, por edhe grante, subvencione dhe alokime të bazuara në projekte. Termi “reklamë shtetërore” si përshkrim i përgjithshëm mund të jetë mashtrues në kontekstin shqiptar, ku shpenzimet direkte për reklamat përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të ndikimit financiar publik mbi mediat.

⁵ Kadriu, E. (2025, Gusht 11). *Journalists show solidarity against the blocking of “News24.”* Citizens.al. <https://citizens.al/en/2025/08/11/gazetaret-solidarizohen-kunder-bllokimit-te-nees24/>

⁶ Në kohën e kryerjes së kërkimeve për këtë artikull, Raporti i Komisionit European për Shqipërinë 2024 ishte burimi më i fundit i disponueshëm dhe për këtë arsye shërbeu si referenca kryesore për analizën e lirisë së medias në vend. Raporti i Komisionit European për Shqipërinë 2025, i cili u konsultua pak para publikimit të këtij studimi, nuk ndryshon në mënyrë thelbësore vlerësimin e Komisionit mbi gjendjen e lirisë së medias, duke konfirmuar rëndësinë e vazhdueshme të gjetjeve të 2024. Shih: Komisioni European. (2024). *Raporti për Shqipërinë 2024*. Drejtoria e Përgjithshme për Negociatat e Fqinjësisë dhe Zgjerimit. [Link](#); dhe Komisioni European. (2025). *Raporti për Shqipërinë 2025*. Drejtoria e Përgjithshme për Negociatat e Fqinjësisë dhe Zgjerimit. SĒD (2025) 750 final. Bruksel, 4 nëntor 2025

Përqendrimi i lartë i pronësisë mbetet një nga problemet më të theksuara në tregun mediatik shqiptar. Raporti i KE-së vëren se pavarësia e mediave “ndikohet negativisht nga mbivendosja e interesave politike dhe biznesore në aspektin e financimit dhe përmbajtjes, si dhe nga përqendrimi i lartë i pronësisë”.⁷ Kjo dinamikë shtrembëron prioritetet editoriale, duke çuar në autocensurë sistematike dhe mbulim selektiv që favorizon elitën qeverisëse dhe aleatët e saj.

Televizioni komercial dominohet nga një grup i vogël konglomeratesh: Klan, Top Media dhe Vizion Plus,⁸ së bashku me Focus Group (në pronësi të Irfan Hysenbelliut) dhe mediat e Carlo Bollinos. Këto grupe operojnë në televizion, radio, portale online dhe, në disa raste, në televizionin me pagesë ose platformat shpërndarëse. Media Ownership Monitor e BIRN-it gjeti se katër pronarët më të mëdhenj përbëjnë afërsisht 87% të audiencës televizive, me dy grupet kryesore që përfituan mbi 60% të të ardhurave të tregut në vitin 2023. Ky përqendrim është pothuajse dy herë më i lartë se niveli i regjistruar në një studim të BIRN-it në 2018, i cili gjeti se katër pronarët më të mëdhenj kishin midis 48.9% dhe 58.6% të audiencës së kanaleve falas.⁹ Një përqendrim i tillë është jashtëzakonisht i lartë sipas standardeve europiane dhe ngre shqetësime sistematike për pluralizmin.¹⁰

Rreziqet nuk janë vetëm strukturore, por edhe institucionale. Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), organi i ngarkuar të veprjë si rregullator i pavarur, zbaton një kuadër emërimesh që e ekspozon ndaj ndikimit politik. Edhe pse formalisht konsiderohen si të si të pavarur dhe mandatohen për të funksionuar si rregullator dhe monitorues, përbërja e bordit reflekton balancat parlamentare, gjë që mund të ndikojë në perceptimet publike për autonominë.¹¹ Zyrtarët e AMA-s dhe vëzhguesit e tjerë të intervistuar për këtë raport vënë në dukje se kohë e fundit vendimet e bordit rrallë janë sfiduar nga gjykatat apo operatorët mediatikë, pasi vendimet që lidhen me licencimin janë marrë vite më parë, duke reduktuar ndjeshmërinë e menjëhershme politike. Megjithatë, dizajni institucional lë hapësirë për përmirësime që forcojnë pavarësinë funksionale dhe rezistencën ndaj ndërhyrjeve të ardhshme.

Transmetuesi publik është gjithashtu i ekspozuar ndaj kapjes politike. Emërimi i Drejtorit të Përgjithshëm, i cili deri në vjeshtën e 2024 ishte deputet dhe funksionar i partisë në pushtet, ilustronte vijën e paqartë mes mediave shtetërore dhe komunikimit qeveritar.¹² Praktika të tilla shkelin standardet europiane dhe ushqejnë perceptimin se transmetuesi i shërben elitës qeverisëse dhe jo publikut. Pas dorëheqjes së Alfred Pezës në shtator 2024, Parlamenti shqiptar emëroi gazetaren Eni Vasili si Drejtoreshë e Përgjithshme e RTSH në prill 2025, gruaja e parë që mban këtë post. Emërimi i Vasilit pritet të çojë në një transmetues publik më të pavarur. Megjithatë, sistemi i emërimeve parlamentare vazhdon të krijojë hapësirë për ndikim politik.¹³

⁷ Komisioni Europian, Shqipëria, 2024, cit., f. 37.

⁸ Klan, Top Media dhe Vizion Plus zotërojnë licencën kombëtare të transmetimit dhe operojnë platforma digjitale që synojnë diasporën shqiptare, si DigitALB dhe Tring. Të tre grupet kanë marrë statusin e investitorit strategjik nga qeveria, një status i lidhur me investime në turizëm, infrastrukturë dhe ndërtim (shih Vladimir Karaj, “Si ‘përfitimet strategjike’ nga qeveria po rrezikojnë lirinë e medias në Shqipëri,” *Reporter.al*, 12 gusht 2025, <https://www.reporter.al/2025/08/12/si-perfitimet-strategjike-nga-qeveria-po-rrezikojne-lirine-e-medias-ne-shqiperi/>).

⁹ Instituti për Media dhe Komunikim (INA). (2024, 15 tetor). Përqendrimi i pronësisë së medias, që zotëron shumicën e audiencës, e vështirëson punën e gazetarëve. INA Media. <https://ina.media/en/2024/10/15/perqendrimi-i-pronesise-se-medias-qe-zoteron-shumicen-e-audiences-veshtireson-punen-e-gazetareve/>

¹⁰ Shifrat mbi përqendrimin e audiencës të raportuara nga BIRN bazohen në të dhëna të mbledhura për një periudhë njëjavore në vit. Megjithëse kjo përfaqëson aktualisht matjen më të plotë dhe publikisht të disponueshme të përqendrimin mediatik në Shqipëri, kufizimi kohor i të dhënave duhet të merret në konsideratë gjatë interpretimit të rezultateve.

¹¹ Komisioni Europian, Shqipëria, 2024, cit., f. 37.

¹² Komisioni Europian, Shqipëria, 2024, cit., f. 37.

¹³ Radio Televizioni Shqiptar (RTSH), në: Dragomir, M. (2025). State Media Monitor Global Dataset 2025. Qendra për Kërkime në Media dhe Gazetari (Media and Journalism Research Center – MJRC).

<https://statemediamonitor.com/2025/09/radio-televizioni-shqiptar-rtsh/>

Mungesa e transparencës së burimeve të financimit është një tjetër dobësi sistemike. Ligji shqiptar parashikon disa zbardhje për pronësinë e kompanive, por kjo vlen vetëm për mediat audiovizive dhe të shkruara, duke lënë jashtë rregullave të transparencës mediat online.¹⁴ Edhe aty ku zbardhja është e detyrueshme, zbatimi mbetet i dobët dhe i fragmentuar.

Financimi publik i medias përbën një kanal veçanërisht të ndjeshëm për ndikimin. Kuadri ligjor nuk përmban kritere të qarta dhe transparente për shpërndarjen, ndërsa zbatimi është jo transparent. Praktikrat e nënkontraktimit u mundësojnë autoriteteve të anashkalojnë prokurimin konkurrues, duke kanalizuar fondet publike tek media të lidhura politikisht.¹⁵ Kjo shtrembëron tregun dhe forcon lidhjet klienteliste. Opaciteti më i gjerë financiar përfshin mungesën e rregullave të qarta për interesat ekonomike, burimet e financimit, investimet e huaja dhe strukturat e pronësisë. Së bashku me nivelet e larta të informalitetit në ekonomi,¹⁶ kjo mungesë transparence dëmton besimin në sektorin e medias dhe pengon audiencën të dijë se kush kontrollon në fund burimet e lajmeve që u serviren.

Kushtet e pasigurta të punës për gazetarët i përkeqësojnë këto mangësi. Komisioni Europian dokumentoi “siguri të kufizuar dhe kushte të këqija pune për gazetarët”,¹⁷ duke përfshirë pagat e papaguara, orët shtesë të papaguara, punën e detyruar në ditët e pushimeve dhe pushime të padrejta nga puna. Më shumë se 140 gazetarë dhe punonjës mediatikë u pushuan nga puna vetëm te transmetuesi publik midis qershorit 2023 dhe qershorit 2024.¹⁸ Inspektorati Shtetëror i Punës konfirmoi shkelje të ligjit për punësimin dhe sigurimet shoqërore, duke dhënë paralajmërime zyrtare për RTSH-në.¹⁹

Kushte të tilla të pasigurta ushqejnë autocensurën. Gazetarët e rinj, gratë dhe korrespondentët lokalë janë veçanërisht të ekspozuar ndaj shfrytëzimit dhe intimidimit. Me burime të kufizuara financiare dhe njerëzore dhe në mungesë të sindikatave të forta apo shoqatave profesionale të shëndosha, gazetarët nuk kanë mjete për t'i rezistuar presionit nga aktorët politikë dhe pronarët e bizneseve. Ndonëse ekzistojnë iniciativa vetërregulluese si Aleanca për Gazetarinë Etike, ndikimi i tyre është i kufizuar për shkak të polarizimit dhe mungesës së burimeve. Në mungesë të reformave sistemike, vetërregullimi nuk mund të kompensojë këto dobësi strukturore.

2.3 Harta rajonale e rreziqeve

Sfidat me të cilat përballlet peizazhi mediatik i Shqipërisë nuk janë të panjohura. Raportet e Komisionit Europian për Ballkanin Perëndimor për vitin 2024 tregojnë një model të përbashkët rreziqesh sistemike që minojnë lirinë dhe pluralizmin e mediave në të gjithë rajonin.

Maqedonia e Veriut vazhdon të ketë probleme me përqendrimin e pronësisë si dhe të vuajë nga praktika të dobëta për zbardhjen e informacionit, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina ende nuk ka miratuar një ligj mbi transparencën e pronësisë. Problemi i Serbisë është disi i ndryshëm: numri i madh i mediave që konkurrojnë në një treg të vogël i bën ato shumë të varura nga patronët politikë dhe tregtarë, çka sjell ndjeshmëri strukturore ndaj kapjes. Mali i Zi, ndryshe nga fqinjët, ka

¹⁴ Komisioni Europian, Shqipëria, 2024, *cit.*, f. 38.

¹⁵ Komisioni Europian, Shqipëria, 2024, *cit.*, f. 38.

¹⁶ Komisioni Europian, Shqipëria, 2024, *cit.*, f. 52-53.

¹⁷ Komisioni Europian, Shqipëria, 2024, *cit.*, f. 38.

¹⁸ Komisioni Europian, Shqipëria, 2024, *cit.*, f. 38.

¹⁹ Komisioni Europian, Shqipëria, 2024, *cit.*, f. 52-53.

përditësuar legjislacionin e tij për të adresuar problemet e transparencës së pronësisë, por opaciteti financiar vazhdon të jetë problem për shkak të zbatimit të dobët të rregullave për përdorimin e fondeve publike në sektorin mediatik.

Mbivendosjet midis politikës dhe biznesit janë një tjetër dukuri që përsëritet. Në Maqedoninë e Veriut dhe Bosnjë e Hercegovinë, Komisioni nënvizon përdorimin e reklamave shtetërore pa kriteret transparente, duke paralajmëruar për rreziqet e manipulimit politik. Serbia shpesh evidentohet për ndikimin e aktorëve politikë dhe ekonomikë mbi përmbajtjen editoriale, veçanërisht të transmetuesit publik. Mali i Zi ka miratuar më shumë ligje që lidhen me transparencën e financimit publik, por pa monitorim efektiv, ky legjislacion ka pasur ndikim të kufizuar.

Shqetësimet mbi pavarësinë e rregullatorëve dhe transmetuesve publikë gjithashtu shfaqen në të gjitha raportet e vendeve, ndonëse me intensitete të ndryshme. Në Serbi, Komisioni ngre dyshime të hapura mbi pavarësinë e rregullatorit dhe dokumenton mbulimin e pabalancuar të aktorëve nga transmetuesit publik gjatë zgjedhjeve. Bosnja dhe Hercegovina përballet me mbikëqyrje të fragmentuar, problem strukturor i rrënjësor në sistemin e saj kompleks politik. Maqedonia e Veriut kritikohet më pak për kapje rregulatore dhe më shumë për presionet politike të vazhdueshme dhe pavarësinë editoriale të kufizuar. Në Mal të Zi, Komisioni ngre shqetësime të gjera për pavarësinë e mediave, pa identifikuar kapje të drejtpërdrejta institucionale të rregullatorëve.

Kushtet e pasigurta të punës për gazetarët janë një problem tjetër i përbashkët. Në të gjithë rajonin, gazetarët operojnë me kontrata të brishta dhe kanë pak mbrojtje sociale. Redaksitë me burime të kufizuara dhe dobësi strukturore i lënë ata pa mbrojtje adekuate përballë presionit dhe shfrytëzimit.

Pamja e përgjithshme tregon konvergimin e rajonit rreth një grupi rreziqesh sistemike: përqendrim i pronësisë, financim i paqartë (sidomos përmes reklamave shtetërore dhe formave të tjera të financimit publik), rregullim i politizuar dhe të drejta pune të dobëta. Këto rreziqe jo vetëm rrezikojnë gazetarët individualë, por dobësojnë vetë themelet institucionale të pluralizmit mediatik.

Megjithatë, ky konvergjim nuk është vetëm problem, por edhe mundësi. Duke qenë se rreziqet janë rajonale dhe sistemike, zgjidhjet mund të harmonizohen me standardet e përbashkëta europiane. Akti i ri Europian për Lirinë e Medias (EMFA) siguron pikërisht një kuadër të tillë, me dispozita mbi transparencën e pronësisë, shpërndarjen e drejtë të reklamave shtetërore dhe pavarësinë e rregullatorëve dhe mediave publike (*shih 4. Transparenca e pronësisë mediatike: Praktika aktuale përkundrejt standardeve europiane*). Duke lidhur progresin në këto fusha me kriteret e anëtarësimit dhe disbursimin e fondeve IPA,²⁰ Bashkimi Europian ka mundësinë të nxisë reforma që mund të forcojnë sistemet mediatike në të gjithë Ballkanin Perëndimor.

²⁰ Shih më tepër tek https://enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/overview-instrument-pre-accession-assistance_en.

Media në Ballkanin Perëndimor: Pasqyrë e rreziqeve kryesore

Vendi	Përqendrimi i pronësisë & transparencja	Mbivendosjet politikë–biznes & Reklamën shtetërore	Pavarësia e rregullatorëve & transmetuesve publikë	Mbrojtja e të drejtave të punës
Shqipëri	Përqendrim i lartë; mediat online jashtë rregullave të pronësisë; grupet kryesore të biznesit zgjerojnë interesat në media	Marrëdhënie të forta politikë–biznes; nuk ka kriterë të qarta për reklamën publike; nënkontraktimi anashkalon konkurrencën	Emërimet e rregullatorit AMA të cënueshme nga politizimi	Kushtet e pasigurta; paga/orë shtesë të papaguara; pushime masive të stafit në transmetuesin publik
Bosnjë & Hercegovinë	KE rekomandon miratimin e ligjit për transparencën e pronësisë	KE rekomandon përcaktimin e kriterëve për reklamën publike	E ekspozuar ndaj ndikimit politik	Dobësi strukturore; pak burime
Mali i Zi	Nuk evidentohen boshllëqe në transparencën e pronësisë	Parashikime ligjore për transparencën e financimit publik, por zbatim i dobët	Vazhdon shqetësimi për pavarësinë e mediave, por nuk evidentohet kapje e rregullatorit/transmetuesit publik	Pasiguri në punë; sindikalizim i kufizuar
Maqedonia e Veriut	Rreziqe përqendrimi e transparencja e dobët e pronësisë	Fondet shtetërore përdoren për reklamë politike me transparencë të kufizuar	Raporti nuk përshkruan rregullatorët si të dobësuar strukturalisht	Pasiguria në punë evidentohet, por është pak e detajuar
Serbia	Shumë media në treg të vogël reklamash, duke krijuar varësi financiare	Ndikimi politik/ ekonomik mbi median; shtrembërime në mbulimin e transmetuesit publik	Pavarësia e rregullatorit e kontestuar; transmetuesi publik i pabalancuar gjatë zgjedhjeve	Kontrata të pasigurta dhe mundësi të pakta negociimi

Burimi: Përmbledhje nga Qendra për Media dhe Gazetari, bazuar në të dhënat e raporteve të KE-së 2024.²¹

²¹ Komisioni Evropian. (2024). *Raporti për Bosnjë dhe Hercegovinë 2024*. Drejtorja e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit. https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/451db011-6779-40ea-b34b-a0eeda451746_en?filename=Bosnia+and+Herzegovina+Report+2024.pdf

Komisioni Evropian. (2024). *Raporti për Malin e Zi 2024*. Drejtorja e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit. https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a41cf419-5473-4659-a3f3-af4bc8ed243b_en?filename=Montenegro+Report+2024.pdf

Komisioni Evropian. (2024). *Raporti për Maqedoninë e Veriut 2024*. Drejtorja e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit. https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/5f0c9185-ce46-46fc-bf44-82318ab47e88_en?filename=North+Macedonia+Report+2024.pdf

Komisioni Evropian. (2024). *Raporti për Serbinë 2024*. Drejtorja e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit. https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/3c8c2d7f-bff7-44eb-b868-414730cc5902_en?filename=Serbia+Report+2024.pdf

3. Kuadri ligjor dhe institucional për Median

Sistemi mediatik i Shqipërisë është formalisht i përcaktuar nga një sërë ligjesh dhe institucione, por në praktikë funksionon në një mjedis me zbatim të dobët, ndikim politik dhe informalitet të përhapur. Ekzistojnë organe mbikëqyrëse, por pavarësia e tyre është e diskutueshme, ndërsa zbatimi gjyqësor është i pasigurt dhe i pazhvilluar. Si rezultat, sektori është formalisht i rregulluar nga institucione, por në praktikë minohet nga mungesa e transparencës, politizimi dhe mbrojtje të dobëta.

Ligji kryesor është Ligji Nr. 97/2013 për Mediat Audiovizive. Ai përcakton ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive si persona fizikë ose juridikë me përgjegjësi editoriale për përmbajtjen, por edhe organizative për funksionimin e saj.²² Ligji rregullon licencimin, kufizimet e reklamave, kuotat për veprat europiane dhe detyrimet për mbrojtjen e të miturve. Ndryshimet e vitit 2016 dhe 2023 riformuluan dispozitat me qëllim favorizimin e aktorëve ekzistues në treg. Sipas një analize, “legjislacioni nuk trajton pronësinë e kryqëzuar, pasi nuk mediat online nuk rregullohen, kurse mediat e shkruara rregullohen me dy nene të përgjithshme mbi lirinë e medias, pa u plotësuar me rregulla të tjera.”²³

Ligji për të Drejtën e Informimit është gjithashtu i rëndësishëm, duke detyruar institucionet të sigurojnë qasje publike në dokumente. Në praktikë, zbatimi është i pabarabartë: zyrtarët shpesh përdorin sekretin tregtar për të fshehur kontrata ose tenderë.²⁴ Për më tepër, ndërsa ligji krijon një kuadër formal për kërkimin dhe marrjen e informacionit, institucionet shpesh shfrytëzojnë maksimumin e afateve për përgjigje ose dorëzojnë të dhëna në formate të vështira për t’u përdorur, duke vonuar raportimin gazetaresk dhe duke dobësuar aktualitetin e lajmit.²⁵ Këto praktika kanë bërë që gazetaret të mbështeten gjithnjë e më shumë tek burime alternative, shpesh jozyrtare. Grupet e shoqërisë civile, shoqatat e medias dhe organizatat ndërkombëtare për lirinë e shtypit kanë shprehur shqetësim edhe për vendimin e Qeverisë Shqiptare në 2021 për të centralizuar komunikimin publik nën Agjencinë e Medias dhe Informacionit (MIA). Kritikant vënë në dukje se kjo strukturë kufizon qasjen në informacion dhe konsolidon kontrollin e qeverisë mbi rrjedhën e informacionit publik.

Legjislacioni dytësor i lëshuar nga AMA mbulon licencimin, kuotat e reklamave dhe sponsorizimin, por juridiksioni i AMA-s nuk përfshin mediat e shkruara ose online.²⁶ AMA vetë është rregullatori kryesor, përgjegjës për licencimin, alokimin e frekuencave dhe monitorimin e përmbajtjes. Ai mban gjithashtu një bazë të dhënash të referuar gjerësisht mbi pronësinë audiovizive. Megjithatë, pavarësia e tij është e brishtë: anëtarët e bordit emërohen nga parlamenti, duke i lënë vendimet e tij të cenueshme përballë shumicave politike.²⁷

²² Republika e Shqipërisë. (2013). *Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*. Autoriteti i Mediave Audiovizive, f. 3. <https://ama.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Law-no.-97-2013-on-the-Audiovisual-Media-in-the-Republic-of-Shqipëria.pdf>

²³ Londo, I. 2025, *cit.*

²⁴ Londo, 2025, *cit.*, f. 26-27.

²⁵ Bino, B. (2023). *Shqipëria – Treguesit e Nivelit të Lirisë së Medias dhe Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve 2023*. f. 22. <https://safejournalists.net/wp-content/uploads/2024/10/ALB-ENG-2024.pdf>.

²⁶ IJAS. (2023, 3 nëntor). *Rrjeti SafeJournalists monitoron planin e veprimit të Qeverisë Shqiptare për adresimin e sigurisë së gazetarëve*. <https://safejournalists.net/alert/safe-journalists-netëork-monitors-Shqipërian-government-roadmap-addressing-safety-of-journalists/>

Taylor, A. (2022, 5 maj). *“Ministria e Propagandës” në Shqipëri: Ku jemi sot? Media Freedom Rapid Response (MFRR)*. <https://www.mfrr.eu/Shqipërian-ministry-of-propaganda-where-we-are-today/>

Matlija, D., Dule, I., & Qershori, B. (2024). *E drejta e informimit 2023: Ndryshimet ligjore për të drejtën e informimit – shumë zhurmë për asgjë? Qendra “Res Publica”*. https://www.respublica.org.al/wp-content/uploads/2024/04/E-drejta-e-informimit-2023_Web.pdf

²⁷ Komisioni European, Shqipëria, 2024, *cit.*, f. 37.

Transmetuesi publik RTSH është një tjetër shtyllë institucionale. Me një buxhet rreth 21 milionë euro në 2023, prej të cilit 29% nga buxheti i shtetit, ai ka peshë financiare të konsiderueshme.²⁸ Megjithatë, pavarësia e tij është komprometuar shumë herë në të kaluarën nga emërime me ndikim politik në Këshillin Mbikëqyrës dhe në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm.²⁹

Vetërregullimi përfaqësohet nga Këshilli Shqiptar i Medias dhe Aleanca për Mediat Etike. Kjo e fundit përfshin më shumë se 30 media dhe ka trajtuar një numër gjithnjë në rritje ankesash, nga 31 në 2021 në 67 në 2023, shenjë e rritjes së ndërgjegjësimit mbi këto mekanizma.³⁰ Kjo organizatë mbulon kryesisht mediat online.

Transparenca e reklamave është një tjetër pikë e dobët. AMA monitoron volumin e reklamave, por jo të ardhurat. Financimi publik për mediat shpesh kanalizohet përmes nënkontraktorëve, duke fshehur përfituesit përfundimtarë.

Organizatat e shoqërisë civile, përfshirë shoqatat profesionale dhe sindikatat, luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm për të kompensuar dobësitë institucionale në sektorin mediatik shqiptar. Gazetarët dhe profesionistët e medias kanë një shkallë të konsiderueshme lirie për t'u organizuar përmes sindikatave dhe shoqatave. Këto përfshijnë Bashkimin e Gazetarëve Shqiptarë (UGSH),³¹ më i vjetri dhe më i madhi, me degë në 12 qarqe, edhe pse funksionon më shumë si shoqatë sesa sindikatë formale; Shoqatën e Gazetarëve Profesionistë të Shqipërisë (APJA),³² e lidhur me Federatën Europiane të Gazetarëve (EFJ); Shoqatën e Gazetarëve të Shqipërisë (AGSH),³³ themeluar në 2024 dhe gjithashtu e lidhur me EFJ; dhe seksionin shqiptar të Shoqatës Europiane të Gazetarëve (AEJ Albania)³⁴. Për më tepër, një sindikatë e re, Bashkimi i Gazetarëve dhe Profesionistëve të Medias në Shqipëri (SGPM),³⁵ u themelua në vjeshtën e 2024 për të përfaqësuar të drejtat e punës dhe interesat kolektive në sektor, ndërsa Rrjeti i Grave Gazetare u krijua po atë vit,³⁶ me qëllim forcimin e përfaqësimit gjinor dhe solidaritetit mes profesionistëve.

Qendra për Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV), një *think tank* me bazë në Tiranë, ka qenë aktive në mbrojtjen e lirisë së medias dhe formësimin e debatit publik përmes kërkimeve, avokatisë dhe deklaratave publike të bëra në kohë.³⁷ SCiDEV është shfaqur, gjithashtu, si aktor kyç në fushën e dijes dhe ndërtimit të kapaciteteve, duke shërbyer si partner lokal për Rrjetin SafeJournalists,³⁸ dhe duke lehtësuar bashkëpunimin rajonal për sigurinë e gazetarëve, kushtet e punës dhe të drejtat mediatike. Grupet monitoruese, si BIRN Albania,³⁹ ofrojnë të dhëna të rëndësishme mbi pronësinë dhe përqendrimin, duke ndihmuar në përmirësimin e transparencës së sektorit.

²⁸ RTSH. (2024). Raporti vjetor 2023. RTSH. Konsultuar më 13 shtator 2025 tek <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202406031108528162Raporti%20i%20veprimtarisë%20së%20punës%20RTSH%202023%20.pdf>.

²⁹ Bino, B., Shehaj, I., & Elmasllari, D. (2024). *Transmetuesi publik i Shqipërisë RTSH: Kundërshtitë mbi përzgjedhjen e drejtorit – një analizë e shkurtër*. SCiDEV, Tiranë. <https://scidevcenter.org/ep-content/uploads/2025/02/SCiDEV-Abalylsis-about-RTSH-Situation.pdf>

³⁰ Londo, 2025, *cit.*, f. 10.

³¹ Shih më tepër tek <https://www.facebook.com/UnioniGazetareveShqiptare>.

³² Shih më tepër tek <https://www.facebook.com/p/Shoqata-Gazetarët-Profesionistë-të-Shqipërisë-APJ-Shqipëria-100069907973361/>.

³³ Shih më tepër tek <https://agsh.al/>.

³⁴ Shih më tepër tek <https://aej.org/about-the-association-of-european-journalists-aej/>.

³⁵ Shih më tepër tek <https://www.sgpm.al>.

³⁶ Shih më tepër tek <https://www.facebook.com/profile.php?id=61566115200716>

³⁷ Shih më tepër tek <https://scidevcenter.org/>.

³⁸ Shih më tepër tek <https://safejournalists.net>.

³⁹ Londo, 2025, *cit.*, f. 9-10.

4. Transparenca e pronësisë së medias: praktika aktuale kundrejt standardeve europiane

4.1 Çfarë kërkojnë EMFA/AVMSD-ja?

Bashkimi Europian ka ndërtuar gradualisht një kuadër ligjor për të mbrojtur pluralizmin e mediave dhe transparencën e pronësisë, duke filluar me Direktivat për Shërbimet Mediatike Audiovizive (AVMSD), të miratuara për herë të parë në 2010 dhe të ndryshuara në 2018, dhe duke kulmuar me Aktin Europian për Lirinë e Medias (EMFA), i cili u miratua në maj 2024 dhe hyri në fuqi në gusht 2025. Së bashku, këto instrumente përcaktojnë standarde të plota për zbardhjen e pronësisë, transparencën e financimit, pavarësinë e rregullatorëve dhe qeverisjen e mediave publike.

AVMSD-ja kërkon që shtetet anëtare të marrin masa që shërbimet mediatike audiovizive, si televizionet ashtu edhe platformat me kërkesë, të respektojnë standardet bazë për licencimin, mbrojtjen e të miturve, reklamën dhe paanshmërinë. Ajo inkurajon transparencën e pronësisë, por zbatimin e lë kryesisht në diskrecionin e shteteve.

EMFA përfaqëson një forcim vendimtar të mbikëqyrjes në nivelin e BE-së. Akti transformon detyrimet jo-shtrënguese në rregulla të detyrueshme, duke shtrirë kërkesat për transparencë në të gjitha sektorët e mediave dhe duke futur monitorimin e pavarur europian përmes Bordit Europian për Shërbimet Mediatike (EBMS).

EMFA është përpjekja më ambicioze e BE-së për të “mbrojtur mediat nga kapja,” pasi synon drejtpërdrejt katër fushat më të ndjeshme ndaj kapjes, sipas Raportit për Monitorimin e Kapjes së Medias (MCMR):⁴⁰

Pavarësia e rregullatorëve të mediave: Duke u mbështetur në Nenin 30 të AVMSD-së, EMFA kërkon që rregullatorët të jenë ligjërisht dhe funksionalisht të pavarur, të pajisur me burime të mjaftueshme dhe të mbrojtur nga emërimet politike. Ata duhet të ndjekin procedura transparente vendimmarrjeje, të publikojnë vendimet dhe të ofrojnë mundësi ankimi. EBMS-ja do të monitorojë zbatimin.

Pavarësia e mediave publike: Neni 5 i EMFA-s garanton autonominë e mediave publike, përmes emërimeve transparente dhe jo-diskriminuese të anëtarëve të bordeve, dhe financimit të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm, jashtë çdo presioni politik. MCMR-ja thekson se mediat publike janë veçanërisht të ndjeshme ndaj kapjes për shkak të afërsisë me shtetin.⁴¹

Keqpërdorimi i fondeve shtetërore: Neni 25 vendos detyrime strikte për transparencën e reklamave shtetërore (dhe formave të tjera të fondeve publike) dhe kontratave të shërbimit. Qeveritë dhe kompanitë shtetërore duhet të publikojnë alokimet vjetore për çdo media, bazuar në kritere transparente dhe proporcionale. MCMR-ja identifikon reklamën shtetërore si një nga mjetet më efektive të kapjes politike në Europë.⁴²

Transparenca e pronësisë dhe pluralizmi: Nenet 6 dhe 22 vendosin rregulla të reja. Neni 6 kërkon zbardhjen e pronarëve të drejtpërdrejtë, të tërthortë dhe përfitues, përfshirë aksionet e shtetit, të

⁴⁰ Detreköi, Z., & Dragomir, M. (2025). *Media Capture Monitoring Report: Overview*. International Press Institute & Media and Journalism Research Center.

<https://journalismresearch.org/ep-content/uploads/2025/02/Media-Capture-Monitoring-Report-Overview.pdf>.

⁴¹ Detreköi & Dragomir, 2025, *cit.*, f. 7.

⁴² Detreköi & Dragomir, 2025, *cit.*, f. 7-8.

ardhurat nga reklamat shtetërore dhe konfliktet e interesit. Informacioni duhet të konsolidohet në një bazë të dhënash publike, e cila mbikëqyret nga rregullatorët. Neni 22 sanksionon një test pluralizmi për rastet e përqendrimit të pronësisë, duke kërkuar vlerësim jo vetëm sipas ligjit të konkurrencës, por edhe për ndikimin në pavarësinë editoriale dhe diversitetin.

Së bashku, këto dispozita synojnë të sigurojnë transparencën e pronësisë dhe financimit të mediave, duke adresuar rreziqet strukturore të kapjes, politizimit dhe përqendrimit oligarkik. Megjithatë, efektiviteti i EMFA-s do të varet nga zbatimi: qeveritë me rekorde të dobëta në lirinë e medias mund të përmbushin kërkesat formale, por të minojnë pavarësinë në praktikë.⁴³ Pa monitorim të fortë dhe vullnet politik, EMFA rrezikon të mbetet vetëm një “tekst ligjor” dhe jo një garanci transformuese.

4.2 Shqipëria sot: Vetëm transparenca nuk mjafton

Shqipëria ka bërë përparim të rëndësishëm drejt transparencës së pronësisë, kryesisht përmes krijimit të regjistrit të AMA-s, i cili ve në dispozicion të publikut informacionin mbi pronarët e transmetuesve të licencuar. Ky është një hap i rëndësishëm përpara, pasi siguron për herë të parë një pasqyrë sistematike se kush kontrollon mediat kryesore televizive dhe radiofonike në vend.

Megjithatë, ky publikim nuk garanton pluralizmin. Transparenca duhet të shkojë përtej emrave, duke përfshirë të dhëna financiare si burimet e financimit, të ardhurat dhe lidhjet me interesa të tjera biznesi. Pa këtë nivel më të thellë të zbardhjes së fakteve, rregullatorët nuk mund të vlerësojnë dominimin e tregut apo ndikimin e aktorëve jashtë medias mbi agjendat editoriale. Për më tepër, regjistri nuk përfshin mediat e shkruara dhe online, duke lënë qindra portale jashtë çdo kërkesë për transparencë. Zgjerimi i kuadrit do të kërkonte një ligj të ri, duke qenë që AMA nuk ka mandat për të rregulluar mediat online.

Rregullimi i pronësisë së kryqëzuar është një boshllëk tjetër i madh. Shqipëria nuk ka kufizime që pengojnë konglomeratet të zotërojnë media televizive, të shkruara apo digjitale. Madje, ndryshimet në Ligjin për Mediat Audiovizive në 2016 lehtësuan kufizimet e mëparshme, duke mundësuar konsolidimin e mëtejshëm në procesin e kalimit nga sistemet analoge në ato digjitale. Sot, tregu dominohet nga një grusht familjesh: familja Frangaj (Klan Group), familja Hoxha (Top Media), familja Dulaku (Vizion Plus), familja Hysenbelliu (Focus Group) dhe Carlo Bollino (Multimedia Group). Këto konglomerate shtrijnë ndikimin e tyre në platforma dhe sektorë të tjerë si ndërtimi, bankat dhe energjia. Mbledhja dhe publikimi i informacionit sistematik mbi pronësinë e tyre ndër-sektoriale dhe lidhjet politike është thelbësor për vlerësimin e rreziqeve të kapjes.

Të dhënat për audiencën janë një tjetër fushë ku Shqipëria mbetet prapa. Të dhënat e besueshme dhe transparente për audiencën janë të domosdoshme për vlerësimin e pluralizmit mediatic, pasi tregojnë jo vetëm kush zotëron mediat, por edhe kush arrin realisht tek publiku. Në Shqipëri, matja e audiencës është futur së fundmi nga vetë transmetuesit, dhe procesi është vënë në pikëpyetje gjerësisht për metodologjinë dhe besueshmërinë e tij. Pa të dhëna të qëndrueshme dhe publike për audiencën, politikëbërësit dhe rregullatorët nuk mund të vlerësojnë se sa i përqendruar është tregu në praktikë. Kjo pritet të ndryshojë, pasi AMA ka porositur së fundmi një kompani private për të kryer hulumtime mbi audiencën për të gjithë industrinë shqiptare.⁴⁴

⁴³ Detreköi & Dragomir, 2025, *cit.*, f. 8-9.

⁴⁴ Intervistë me Armela Krasniqin, kryetare e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA).

E njëjta situatë vlen për të dhënat mbi reklamat, ku edhe shifrat bazë janë të kontestuara dhe pak dihet mbi të ardhurat që rrjedhin për mediat online. Për një sektor gjithnjë e më shumë të formësuar nga platformat digjitale, kjo mungesë transparence është veçanërisht e dëmshme.

Më në fund, financimi publik për mediat, përfshirë shpenzimet për reklama, nxjerr në pah dobësitë e sistemit aktual. Shqipëria nuk ka një skemë formale subvencionimi, por ministritë, komunat dhe kompanitë shtetërore shpërndajnë reklama dhe financime për projekte përmes ndërmjetësve. Ky sistem nuk ka transparencë, është i fragmentuar dhe mundëson shpërndarjen klienteliste. Sipas studimit *Our Media*, “legjislati dhe mekanizmat për ndarjen e fondeve publike në media nuk lejojnë një analizë të shëndoshë dhe konkluzione të qëndrueshme për këtë proces.”⁴⁵

Ky peizazh tregon se vetëm transparenca nuk mjafton. Shqipëria ka bërë një hap pozitiv me krijimin e regjistrimit të AMA-s, por mungesa e detyrimeve për zbardhjen e plotë të pronësisë, rregullave për pronësinë e kryqëzuar, të dhënave të besueshme për audiencën dhe reklamat, si dhe praktikave transparente për financimin shtetëror, bëjnë që rreziqet e kapjes dhe oligarkizimit të mbeten të larta. Transparenca është një kusht i domosdoshëm për reformë, por pa rregulla shoqëruese që parandalojnë dominimin dhe sigurojnë financim të drejtë dhe pavarësi rregullatore, ajo nuk mund të sjellë pluralizëm të vërtetë.

4.3 Matrica e analizës së boshllëqeve

Mospërputhja e Shqipërisë me EMFA-n nuk është e pjesshme, por sistematike. Vendi mbetet prapa në disa fusha kyçe, duke lënë hapur boshllëqe të mëdha, disa prej të cilave janë përshkruar më sipër.

Boshllëqet kritike shfaqen në tre fusha: zbardhja e pronësisë, transparenca financiare dhe rregullat e pronësisë së kryqëzuar. Regjistri i AMA-s është një hap përpara për mediat audiovizive, por ai përjashton mediat e shkruara dhe online dhe nuk mbulon pronësinë e përfituesve apo burimet e financimit. Kjo lë të paprekura rrjetet e fshehta të ndikimit. Kompanive mediatike nuk iu kërkohet të publikojnë të ardhurat apo të zbulojnë burimet kryesore të të ardhurave, ndërsa financimi publik për mediat vazhdon të kanalizohet përmes ndërmjetësve jo transparentë, duke e lënë publikun dhe rregullatorët pa dijeni se kush realisht e financon sektorin. Për më tepër, Shqipëria nuk ka rregulla për pronësinë e kryqëzuar. Si rezultat, pesë konglomerate, siç u përmend më lart, dominojnë tregun, duke shtrirë ndikimin e tyre në mediat televizive, të shkruara dhe online dhe duke ruajtur lidhje të ngushta politike.

Disa boshllëqe lidhen me pavarësinë e transmetuesit publik (RTSH) dhe të rregullatorit (AMA). Në letër, dispozitat për pavarësinë e tyre ekzistojnë dhe, në parim, këto institucione së paku në vitet e fundit kanë mbrojtur pluralizmin. Në praktikë, megjithatë, strukturat e tyre të qeverisjes mbeten të ekspozuara ndaj ndikimit politik përmes procedurave të emërimeve parlamentare dhe varësive nga burimet financiare. Pavarësia e AMA-s është e përcaktuar ligjërisht, por institucionalisht është e brishtë, pasi udhëheqja e saj varet nga shumicat parlamentare. Depolitizimi i procedurave të emërimeve dhe i sistemeve të financimit do ta afronte AMA-n më pranë standardeve të EMFA-s.

Boshllëqe të moderuara shfaqen edhe në lidhje me të dhënat për audiencën dhe tregun. Ndërsa EMFA nuk detyron formalisht Shtetet Anëtare të publikojnë të dhëna të tilla, testi i pluralizmit sipas

⁴⁵ Londo, 2025, *cit.*, f. 17.

Nenit 22 varet nga informacioni i besueshëm mbi pjesët e audiencës dhe të ardhurat e tregut. Në Shqipëri nuk ka të dhëna të besueshme për audiencën, dhe shifrat e reklamave janë po aq të errëta. Pa shifra të besueshme dhe transparente, rregullatorët nuk kanë mjete të sigurta për të ndjekur përqendrimin ose për të zbuluar kapjen.

Në përmbledhje, përpjekjet e AMA-s për rritjen e transparencës janë një hap i dobishëm fillestar, por kjo nuk mjafton. Pamja më e gjerë është një mjedis i errët i mundësuar nga kapja. Mbyllja e këtyre boshllëqeve do të kërkojë më shumë sesa zgjidhje inkrementale: Shqipëria ka nevojë për një ligj të ri, gjithëpërfshirës për median, që të zgjerojë transparencën e pronësisë dhe financimit në të gjitha sektorët, të vendosë kufizime të kuptimplotë për pronësinë e kryqëzuar, të sigurojë shpërndarje të drejtë dhe transparente të fondeve shtetërore dhe të depolitizojë qeverisjen e rregullatorëve dhe të mediave publike. Transparenca është e domosdoshme, por pa mbrojtje të zbatueshme, mediat shqiptare do të mbeten të ekspozuara ndaj oligarkizimit dhe kontrollit politik. [\(për më shumë shih më poshtë 4.4 Rreziqet në praktikë\)](#)

Përputhshmëria e kuadrit mediatic të Shqipërisë me standardet EMFA/AVMSD: Vlerësimi i boshllëqeve

Fusha	Standardi EMFA/AVMSD	Situata e Shqipërisë sot	Boshllëku	Statusi EMFA
Zbardhja e pronësisë	Zbardhje e plotë e pronarëve të drejtpërdrejtë, të tërthortë dhe përfitues në një regjistër publik që mbulon të gjithë sektorët e mediave (Art. 6 & 22 EMFA)	Regjistri i AMA-s mbulon vetëm sektorin audioviziv; media e shkruar dhe online është e përjashtuar; pronari përfitues mbetet i fshehur; AMA nuk ka mandat mbi portalet	Boshllëk kritik: nuk ka zbardhje universale; nuk ka të dhëna për pronarët përfitues; kërkohet ligj i ri	Detyrim i qartë EMFA
Transparenca financiare	Zbardhja e burimeve të të ardhurave, përfshirë financimin publik për mediat, subvencionet dhe investitorët privatë (Art. 6 & 25 EMFA)	Nuk ka detyrim për publikimin e raporteve financiare; burimet e financimit janë të fshehura; financimi publik shpesh kanalizohet përmes ndërmjetësve	Boshllëk kritik: rregullatorët nuk kanë të dhëna financiare për të vlerësuar ndikimin në treg	Detyrim i qartë EMFA
Garancitë për pluralizmin (pronësia e kryqëzuar)	Rregullatorët duhet të vlerësojnë bashkimet e kompanive dhe pronësinë e kryqëzuar lidhur me ndikimin mbi pluralizmin dhe pavarësinë editoriale (Art. 22 EMFA)	Nuk ka rregulla për pronësinë e kryqëzuar; kufizimet u lehtësuan në 2016; pesë konglomerate dominojnë tregun, me lidhje të ngushta politike	Boshllëk kritik: nuk ka mjete ligjore për të parandaluar oligarkizimin ose kapjen politike	Detyrim i qartë EMFA

Fusha	Standardi EMFA/ AVMSD	Situata e Shqipërisë sot	Boshllëku	Statusi EMFA
Të dhënat mbi audiencën dhe tregun	EMFA kërkon vlerësime të pluralizmit (Art. 22) → të dhënat e besueshme për audiencën/të ardhurat e tregut nënkuptohen, por nuk janë shprehimisht të detyrueshme	Matja e audiencës menaxhohet privatisht; metodologjia kontestohet; rezultatet nuk janë publike; të dhënat për tregun e reklamave të pasigurta	Boshllëk i moderuar: nuk ka të dhëna publike dhe të besueshme; kjo dobëson monitorimin e pluralizmit	Kërkesë nënkuptuar (jo shprehimisht e detyrueshme)
Transparenca e financimit publik	Financimi publik për mediat shpërndahet sipas kritereve transparente, objektive dhe proporcionale; Çdo vit të publikohen shumat e dhëna për çdo media (Art. 25 EMFA)	Shpërndarja e fondeve është e errët; fondet kanalizohen përmes agjencive; ministritë dhe ndërmarrjet shtetërore përdorin kritere jo-transparente	Boshllëk kritik: rrezik i lartë klientelist; mungon transparenca e fondeve shtetërore	Detyrim i qartë EMFA
Pavarësia e mediave publike	Emërime transparente, bazuar në meritë; programe financimi të qëndrueshme dhe afatgjata (Art. 5 EMFA)	Emërimet në RTSH të ekspozuara ndaj politizimit; Drejtori i Përgjithshëm dhe Këshilli Mbikëqyrës caktohen nga shumicat parlamentare; një e treta e buxhetit nga shteti	Boshllëk i madh: kuadri ekziston, por dobësohet nga kapja politike	Detyrim i qartë EMFA
Pavarësia e rregullatorit	Rregullatori duhet të jetë ligjërish dhe funksionalisht i pavarur; emërime transparente; burime të mjaftueshme; mbikëqyrje nga kolegët (Art. 30 EMFA & AVMSD)	Emërimet në AMA të ekspozuara ndaj politizimit; varet nga shumica parlamentare; kapacitete zbatuese të dobëta	Boshllëk i madh: rregullatori ekziston, por autonomia dhe besueshmëria janë të brishta për shkak të rreziqeve të politizimit	Detyrim i qartë EMFA

Shënim mbi klasifikimin e boshllëqeve: **Boshllëk kritik** – nuk ekziston një kuadër ligjor efektiv ose masat ekzistuese janë krejtësisht të pamjaftueshme për të përmbushur standardet EMFA; reforma është urgjente dhe duhet të fillojë nga themeli (p.sh. zbardhja e pronësisë, transparenca e financimit, garancitë kundër pronësisë së kryqëzuar). **Boshllëk i madh** – ekzistojnë institucione ose rregulla, por ato kompromentohen në praktikë për shkak të ndikimit politik, zbatimit të dobët ose mangësive strukturore; nevojiten reforma domethënëse për t'u linjzuar me EMFA-n (p.sh. pavarësia e rregullatorit dhe e transmetuesit publik). **Boshllëk i moderuar** –masat ekzistojnë pjesërisht, por u mungon besueshmëria, qëndrueshmëria ose nuk janë në dispozicion të publikut; këto mangësi dobësojnë monitorimin dhe vlerësimin e pluralizmit, por mund të përmirësohen me reforma të synuara (p.sh. të dhënat për audiencën dhe tregun).

Burimi: Marius Dragomir dhe Qendra për Kërkime në Media dhe Gazetari

4.4 Rreziqet në praktikë

Boshllëqet sistemike midis kuadrit aktual të Shqipërisë dhe standardeve të përcaktuara nga EMFA nuk janë abstrakte apo teknike; ato përkthehen drejtpërdrejt në rreziqe që tashmë janë konkrete në praktikë. Më e dukshmja dhe më e rrënjësura ndër to është oligarkizimi i tregut mediatik.

Siç thuhet më sipër në raport, sektori audioviziv i Shqipërisë dominohet nga disa konglomerate familjare. Një përqendrim i tillë do të ishte problematik në çdo kontekst, por në Shqipëri bëhet edhe më serioz nga fakti se këto konglomerate kanë interesa të mëdha edhe në industritë jo-mediatike si ndërtimi, bankat, telekomunikacioni dhe energjia.

Mungesa e rregullave për pronësinë e kryqëzuar ka i ka lejuar këto konglomerate të shtrijnë ndikimin e tyre nëpër platforma të ndryshme. Dominimi në televizion shtrihet shpejt në radio, shtyp dhe media digjitale, duke rritur edhe më shumë fuqinë e tyre për të formësuar diskursin publik. Për shkak se Shqipëria nuk ka një mekanizëm për të vlerësuar ndikimin e këtij përqendrimi mbi pluralizmin, kapja mediatike ka avancuar pa pengesa. Rezultati është një ekosistem i mbyllur ku një rreth i vogël pronarësh kontrollojnë informacionin dhe ndikimin.

Ky përqendrim ndikon drejtpërdrejt mbi cilësinë e informacionit. Sipas një raporti të vitit 2023 nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, “presioni dhe kontrolli mbi mediat dhe gazetarët janë gjithashtu një nga mënyrat që përdoren nga individët me fuqi financiare për të manipuluar aktivitetet si dhe lidhjet e tyre me politikën. Për të arritur këtë qëllim, janë përdorur forma të ndryshme, duke përfshirë jo vetëm korrupsionin e individëve të caktuar në botën e medias dhe shtypit, por edhe ofrimin e favoreve të tjera me përfitime ekonomike.”⁴⁶

Dezinformimi gjithashtu lulëzon në këtë mjedis. Portalet online, të cilat operojnë jashtë çdo kërkesë për regjistrim ose zbardhje pronësie, mund të krijohen dhe braktisen brenda natës. Shumë prej tyre fshehin pronësinë dhe burimet e financimit, duke i bërë ato mjete ideale për përmbajtje të sponsorizuara politikisht, reklama të fshehta dhe fushata dezinformimi. Në parim, vetërregullimi mund të ofronte një zgjidhje për këto sfida. Megjithatë, vetërregullimi dhe integriteti në mediat online në Shqipëri minohen nga rrjetet korruptive dhe informale që formësojnë ekosistemin mediatik të vendit. Portalet anonime dhe të pakontrollueshme mbahen nga financat e aktorëve politikë, interesat biznesi dhe, në disa raste, rrjetet e krimin të organizuar.⁴⁷ Këta aktorë përdorin platformat mediatike si instrumente presioni, shantazhi dhe dezinformimi, ndërsa gazetaria etike marginalizohet gjithnjë e më shumë. Kjo errësirë çon në “probleme etike dhe praktika profesionale të dyshimta,” duke dëmtuar besimin në ekosistemin e lajmeve digjitale.⁴⁸ Pa detyrime për zbardhjen e pronësisë ose të financimit, dhe pa ndërprerjen e rrjeteve financiare që mbështesin mediat joetike, nuk ekzistojnë mjete efektive për të mbajtur këto media përgjegjëse ose për të bërë që vetërregullimi të funksionojë siç duhet.⁴⁹

Këto rreziqe përkeqësohen nga abuzimi me fondet publike për mediat. Në vend që të shërbejnë si burim neutral për financimin e mediave të ndryshme, paratë publike shpesh kanalizohen përmes ndërmjetësve jo transparentë dhe shpërndahen sipas besnikërisë politike. Në Ballkan, reklammat

⁴⁶ Hallunaj, M. (2023, janar). *Prirjet oligarkike në Shqipëri dhe nevoja për një proces de-oligarkizimi: Një përpjekje për vlerësimin dhe matjen e përqendrimit të pushtetit ekonomik dhe politik* (Policy Paper nr. 3), f. 21. Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes. <https://csdgalbania.org/ep-content/uploads/2023/03/Policy-Paper-3-FINAL-ENG.pdf>

⁴⁷ Burimi: Blerjana Bino, drejtoreshë ekzekutive e SCiDEV (intervistë dhe komente me shkrim).

⁴⁸ Londo, 2025, cit., f. 4.

⁴⁹ Bino, cit

shtetërore (dhe forma të tjera të financimit publik) përdoren nga qeveritë si një instrument efektiv për të kontrolluar linjat editoriale pa censurë të drejtpërdrejtë: duke shpërblyer media të bindura dhe duke privuar mediat kritike, institucionet shtetërore formojnë indirekt, por në mënyrë vendimtare, mjedisin e informacionit.

Efekti kumulativ i këtyre dinamikave është një sistem mediatik që më gjerësisht pasqyron ekonominë politike oligarkike të Shqipërisë. Pronarët e mediave përdorin platformat e tyre më pak si biznese të qëndrueshme dhe më shumë si karta negociimi me shtetin. Politikanët, nga ana tjetër, mbështeten tek mediat e kapura për të ruajtur dominimin dhe për të kontrolluar narrativat. Gazetarët, duke punuar në kushte të pasigurta, kanë pak mbrojtje nga ndërhyrjet editoriale ose presioni politik. Megjithatë, e dukshme është edhe dinamika e kundërt: gazetarë, të formuar nga i njëjti mjedis korruptiv, kanë përvetësuar dhe ushtrojnë në shkallë më të vogël praktikatat shantazhuese të punëdhënësve apo patronëve të tyre politikë. Në analizë të fundit, informacioni që mbërrin tek publiku është i filtruar në përputhje me interesat e biznesmenëve dhe politikanëve të fuqishëm, duke lënë hapësirë të kufizuar për zëra realisht të pavarur.

5. Standardet ndërkombëtare dhe qasjet europiane

5.1 Standardet

Në gjithë Europën, ekzistojnë disa shtylla normative që formësojnë qasjen aktuale ndaj pronësisë mediatike dhe pluralizmit.

Një prej tyre ofrohet nga Këshilli i Europës (CoE) dhe përcakton arkitekturën kryesore. Rekomandimi CM/Rec(2007)2 inkurajon shtetet anëtare të kufizojnë ndikimin e pronarëve të vetëm, duke vendosur pragje objektive, si përqindja e audiencës, tirazhi, qarkullimi/të ardhurat dhe të drejtat e kapitalit/votimit, si dhe duke fuqizuar rregullatorët për të refuzuar licencat, për të vendosur masa korrigjuese dhe, kur është e nevojshme, për të urdhëruar ndarjen në mbrojtje të pluralizmit.⁵⁰

Rekomandimi CM/Rec(2018)1 e çon më tej këtë kornizë duke kërkuar transparencë të plotë të pronësisë (përfshirë zbardhjen e pronarëve përfitues dhe formave të kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë) dhe duke theksuar rolin strukturor të mediave publike (PSM) dhe mediave komunitare si kundërpeshë ndaj përqendrimit. Ai gjithashtu sugjeron përdorimin e mjeteve financiare për të mbështetur gazetarinë e pavarur cilësore (Këshilli i Europës 2018).⁵¹

Korniza me dy nivele e OSBE-së ka po ashtu një rol të rëndësishëm në vendosjen e standardeve. Dokumenti i Kopenhagës (1990) kodifikon lirinë e shprehjes dhe angazhimin për debat publik pluralist si thelbësor për zgjedhje demokratike,⁵² por nuk vendos vetë rregulla për zbardhjen e pronësisë. Këto rregulla u zhvilluan më vonë përmes udhëzimeve të Përfaqësuesit për Lirinë e Medias (RFoM), vendimeve ministriale dhe deklaratave të përbashkëta. Këto instrumente kërkojnë transparencë të plotë të pronësisë, masa kundër përqendrimit të tepërt, rregullatorë vërtetë të

⁵⁰ Këshilli i Europës. (2007). *Recommendation CM/Rec(2007)2 on media pluralism and diversity of media content*. Gjetet [këtu](#).

⁵¹ Këshilli i Europës (2018). *Recommendation CM/Rec(2018)1 on media pluralism and transparency of media ownership*. Gjetet [këtu](#).

⁵² OSCE. (1990). *Copenhagen Document*. <https://www.osce.org/files/f/documents/d/7/19394.pdf>

pavarur dhe mbështetje të synuar për pluralizmin (përfshirë mediat lokale dhe komunitare). Për shembull, Vendimi Ministrial i vitit 2018 mbi Sigurinë e Gazetarëve riafirmoi angazhimet të OSBE-së për median pluraliste,⁵³ ndërsa komunikatat dhe deklaratat e përbashkëta të RFoM kanë kërkuar nga shtetet që të garantojnë zbardhjen e drejtpërdrejtë të pronësisë për publikun, së bashku me deklaratimet përkatëse pranë rregullatorëve kombëtarë të pavarur.⁵⁴

Së fundmi, EMFA plotëson këto standarde duke integruar detyrime transparence në të gjitha shërbimet mediatike. Ajo kërkon zbardhjen publike të pronarëve të drejtpërdrejtë, të tërthortë dhe përfitues, si dhe publikimin e të ardhurave nga reklamat shtetërore; bën të detyrueshme vlerësimet e ndikimit mbi pluralizmin në rastet e përqendrimit të pronësisë; dhe apelon për sisteme transparente të matjes së audiencës. Këto dispozita forcojnë dhe operacionalizojnë angazhimet më të gjera të përcaktuara nga Këshilli i Evropës dhe OSBE-ja (*shih seksionin 4.1 mbi kërkesat e EMFA/AVMSD*).

5.2 Qasjet europiane për garantimin e pluralizmit të medias

Gjermania (KEK): Pragjet e pjesës së audiencës fiksohen në ligj

Sistemi mediatik i Gjermanisë mbikëqyret nga Komisioni për Përqendrimin në Media (KEK), i cili punon për të mbrojtur pluralizmin e mendimit në televizionet kombëtare.⁵⁵ Në thelb të këtij sistemi qëndron modeli i pjesës së audiencës: pjesa vjetore e audiencës televizive është treguesi vendimtar për të përcaktuar nëse ekzistojnë ndikime dominuese në formimin e opinionit publik.⁵⁶ Nenet 60-68 dhe 120 të Traktatit Ndërshtetëror për Median (Medienstaatsvertrag, MStV)⁵⁷ lejojnë shoqëritë tregtare të transmetojnë disa shërbime televizive kombëtare, për sa kohë që kjo nuk çon në krijimin e një fuqie dominuese në formimin e opinionit. Dominanca prezumohet kur pjesa mesatare vjetore e audiencës televizive arrin 30%, me një prag dytësor prej 25% në rast se subjekti mban një pozitë dominuese në një treg tjetër të rëndësishëm mediatik ose nëse një vlerësim ndërmedial tregon ndikim të barasvlershëm. Të ashtuquajturat “rregulla bonus” lejojnë zbritje nga pjesa e llogaritur e audiencës kur kanali transmeton dritare programore nga rajoni ose programe të palëve të treta, duke kontribuar kështu në mbrojtjen e pluralizmit. Rregullat e atribuimit parandalojnë anashkalimin e këtyre kufizimeve: §62 MStV ia atribuon pjesët e audiencës subjekteve që zotërojnë të paktën 25% të kapitalit në mënyrë të drejtpërdrejtë (ose në mënyrë të tërthortë të kualifikuar), si dhe rasteve të ndikimit të krahasueshëm të krijuar përmes kontratave ose kontrollit mbi vendimmarrjen programore.

Franca (ARCOM): Modeli strukturor i kombinuar me përmbajtjen

Franca zbaton një model hibrid që kombinon kufizime strukturore mbi pronësinë me kufizime ndërmediale dhe mbikëqyrje të bazuar në përmbajtje. Rregullatori audioviziv ARCOM zbaton Ligjin e Transmetimeve të vitit 1986⁵⁸ dhe administron procedurat e licencimit përmes thirrjeve publike për aplikime, në përputhje me nenin 30-1, duke u imponuar subjekteve të licencuara “konventa”

⁵³ OSCE Ministerial Council. (2018). *Decision No. 3/18—Safety of Journalists*. <https://www.osce.org/files/mcdec0003%20safety%20of%20journalists%20en.pdf>.

⁵⁴ RFoM & partners. (2023). *Joint Declaration on Media Freedom and Democracy*. <https://www.osce.org/files/f/documents/3/2/542676.pdf>

⁵⁵ Shih më tepër tek <https://www.kek-online.de/en/about-us/>.

⁵⁶ Shih më tepër tek <https://www.kek-online.de/en/media-concentration-monitoring/>.

⁵⁷ Die Medienanstalten. (2020). *Interstate Media Treaty (Medienstaatsvertrag, MStV)*. https://www.die-medienanstalten.de/fileadmin/user_upload/Rechtsgrundlagen/Gesetze_Staatsvertraege/Interstate_Media_Treaty_en.pdf

⁵⁸ Këshilli i Lartë i Mediave Audiovizive (CSA). (n.d.). Dispozita kundër përqendrimit. CSA. <https://www.csa.fr/Proteger/Garantie-des-droits-et-libertes/Le-dispositif-anti-concentration>.

që përfshijnë detyrime për garantimin e pluralizmit.⁵⁹ Ligji (nenet 35-38) ndalon zotërimin e aksioneve përmes personave të tretë (prête-nom), kërkon që aksionet të jenë nominative dhe detyron subjektet e licencuara të njoftojnë ARCOM-in për çdo ndryshim në strukturën e kapitalit. Pronësia përfituese duhet gjithashtu të regjistrohet në regjistrin kombëtar RBE-së, në përputhje me rregullat kundër pastrimit të parave. Kufizime të posaçme synojnë parandalimin e dominancës: asnjë subjekt i vetëm nuk mund të zotërojë më shumë se 49% të kapitalit ose të të drejtave të votës të një kanali televiziv kombëtar tokësor digjital (DTT) që ka mbi 8% pjesë mesatare vjetore të audiencës. Nëse një subjekt tashmë kontrollon një kanal të tillë, ai nuk mund të zotërojë më shumë se 33% të kapitalit të një kanali televiziv lokal. Një operator i vetëm nuk mund të mbajë më shumë se shtatë autorizime televizive kombëtare. Dispozitat për pronësinë e kryqëzuar kufizojnë më tej përqendrimin, duke ndaluar që aplikantët të mbajnë njëkohësisht pozita dominuese në televizion, radio dhe shtypin e përditshëm. Në rastet kur kompanitë bashkohen, Autoriteti i Konkurrencës udhëheq shqyrtimin nga këndvështrimi i konkurrencës, ndërsa ARCOM jep opinion mbi pluralizmin sipas nenit 41-4 të ligjit të vitit 1986.⁶⁰ Rasti i bashkimit TF1/M6 i vitit 2022 ilustron mënyrën se si vlerësimi i pluralizmit nga ARCOM plotëson kontrollin antitrust.⁶¹ Në korrik 2024, ARCOM forcoi monitorimin e detyrimeve të pluralizmit, veçanërisht për kanalet informative 24-orëshe, një zhvillim i mirëpritur nga organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në fushën e lirisë së medias.⁶² Në korrik 2025, Këshilli i Shtetit (Conseil d'État) sqaroi detyrimin e ARCOM-it për të garantuar që të mos ketë asnjë “çekuilibër të dukshëm dhe afatgjatë” në shprehjen e opinionëve të ndryshme në programacion, veçanërisht në lajme dhe informacion.⁶³

Italia (AGCOM): Matësi ndërmedial SIC dhe testi i ri “i vlerësimit të fuqisë domethënëse në treg”

Rregullatori italian AGCOM zbaton Sistemin e Integruar të Komunikimeve (Sistema Integrato delle Comunicazioni - SIC), një tregues ndërmedial që përfshin shtypin e shkruar, agjencitë e lajmeve, botimin elektronik (përfshirë median online), radion, median audiovizive, kinemanë, reklamat në hapësira të jashtme, sponsorizimet dhe reklamat online.⁶⁴ Më parë, neni 43 i ligjit TUSMAR të vitit 2005 vendoste pragje të përcaktuara, të cilat operatorët të realizonin më shumë se 20% të të ardhurave të SIC (ose më shumë se 10% nëse kontrollonin gjithashtu 40% të të ardhurave nga komunikimet elektronike). Në mars 2024, ky regjim u zëvendësua nga neni 51 i ligjit TUSMA të vitit 2021, i cili prezantoi një standard të ri të “fuqisë domethënëse në treg”, që konsiderohej e dëmshme për pluralizmin. AGCOM tashmë publikon vlerësime vjetore të SIC, vlerat e komponentëve të tregjeve dhe të dhëna për pozitat dominuese, si dhe rreziqet që ato paraqesin për pluralizmin.

⁵⁹ Légifrance. https://www.legifrance.gouv.fr/loda/article_lc/LEGIARTI000044259353.

⁶⁰ Ligji nr. 86-1067 i 30 shtatorit 1986, *cit*.

⁶¹ Këshilli i Lartë i Mediave Audiovizive (CSA). (2021, Shtator 21). *Instruction de l'opération de rapprochement des groupes TF1 et M6: Le CSA adresse aux acteurs concernés un questionnaire pour préparer son avis à l'Autorité de la concurrence*. <https://www.arcom.fr/presse/instruction-de-l-operation-de-rapprochement-des-groupes-tf1-et-m6-le-csa-adresse-aux-acteurs-concernes-un-questionnaire-pour-preparer-son-avis-lautorite-de-la-concurrence>

⁶² Reporterët pa kufij (RSF). (2022, Dhjetor 8). *France: RSF welcomes Arcom's decision to strengthen media pluralism*. RSF. <https://rsf.org/en/france-rsf-ewelcomes-arcoms-decision-strengthen-media-pluralism>.

⁶³ Këshilli i Shtetit. (2024, qershor 26). *Pluralism in television and radio: The Conseil d'État sets out the conditions under which this principle must be monitored by Arcom*. <https://www.conseil-etat.fr/en/neës/pluralism-in-television-and-radio-the-conseil-d-etat-sets-out-the-conditions-under-which-this-principle-must-be-monitored-by-arcom>.

⁶⁴ Shih më tepër tek <https://www.agcom.it/sistema-integrato-delle-comunicazioni-sic>.

Irlanda (Coimisiún na Meán): Rregulla mbi pronësinë dhe kontrollin të lidhura me fondet për gazetarinë

Rregullatori mediatik i Irlandës, Coimisiún na Meán, u themelua në mars 2023 për të mbikëqyrur transmetuesit, ofruesit e shërbimeve VOD dhe platformat online.⁶⁵ Politika e tij për Pronësinë dhe Kontrollin rregullon kontratat e transmetimit dhe të multipleksimit, duke marrë në konsideratë karakterin dhe historikun e aplikantëve, pronarët përfitues të mediave, si dhe respektimin e kriterëve ligjore.⁶⁶ Kjo politikë vendos pragje të qarta: deri në 20% e shërbimeve kombëtare të transmetimit audio konsiderohet e pranueshme; 20–25% kërkon kontrolle shtesë për përputhshmërinë; ndërsa mbi 25% ndalohej. Në nivel lokal, dominanca vlerësohet mbi bazën e pjesës së audiencës. Irlanda gjithashtu lidh rregullat e pronësisë dhe kontrollit me skemat e financimit publik. Rregullatori administron fonde për gazetarinë, si skema Sound & Vision dhe, që nga viti 2024, skemat për raportimin mbi demokracinë vendore dhe për raportimin gjyqësor (fillimisht 6 milionë euro, me 5.7 milionë euro të akorduara në vitin 2025).⁶⁷ Përfitimi nga këto fonde kushtëzohet me respektimin e kërkesave rregullatore dhe transparencën e pronësisë dhe kontrollit, duke krijuar një nxitje të fortë për përputhshmëri.⁶⁸

Zvicra (OFCOM/Publicom): Matja e fuqisë së formësimit të opinionit publik

Zvicra ka zhvilluar një nga sistemet më të sofistikuar të monitorimit ndërmedial në Europë. Media Monitor (*Medienmonitor Schweiz*), i porositur nga Zyra Federale e Komunikimeve (OFCOM) dhe i zbatuar nga Publicom, vlerëson se sa “fuqi formësuese të opinionit” zotërojnë marka dhe pronarë të ndryshëm mediatikë në tregun zviceran.⁶⁹ Sistemi nuk analizon vetëm pjesën që zë një media në treg, por kapacitetin më të gjerë të mediave për të ndikuar në debatin publik. Për të matur këtë kapacitet, ai kombinon të dhëna mbi mbulimin e audiencës (studime zyrtare mbi mbulimin ditor për televizionin, radion dhe shtypin, të plotësuara me anketa dhe projeksione për median online dhe rrjetet sociale), të dhëna mbi rëndësinë e perceptuar (anketa përfaqësuese ku përdoruesit vlerësojnë sa e rëndësishme është secila markë për ta si burim informacioni politik dhe shoqëror), si dhe tregues të përqendrimit (dy elementët e mësipërm integrohen në një indeks të fuqisë formësuese të opinionit për çdo markë dhe për çdo pronar). Këto të dhëna më pas agregohen për të gjitha markat që i përkasin të njëjtit grup mediatik. Në fazën përfundimtare, rezultatet përpunohen përmes Indeksit Herfindahl–Hirschman (HHI), një instrument standard i politikës së konkurrencës, për të matur nivelin e përgjithshëm të përqendrimit në sistem. Të dhënat që dalin tregojnë se si shpërndahet fuqia formësuese e opinionit ndërmjet pronarëve në nivel kombëtar, sipas rajoneve gjuhësore dhe në nivel lokal, si dhe nëse përqendrimi po rritet apo po ullet me kalimin e kohës. Monitori mbulon rreth 170 marka mediatike dhe nëntë grupe të mëdha, duke përfshirë televizionin, radion, shtypin, median online dhe rrjetet sociale. Duke qenë ndërmedial dhe duke kombinuar si treguesit sasiorë të mbulimit, ashtu edhe vlerësimet cilësore nga përdoruesit, ai kap dimensione të ndikimit që matësit e thjeshtë ekonomikë nuk do t'i identifikonin. OFCOM publikon raporte periodike dhe përditësime metodologjike, duke i bërë gjetjet transparente dhe të përdorshme si bazë të dhënash për politikëbërjen. Kjo u mundëson politikëbërësve të ndjekin në kohë reale rreziqet ndaj pluralizmit, ndërsa studiuesve, gazetarëve dhe publikut u ofron një pasqyrë të qartë mbi aktorët që formësojnë opinionin publik në mjedisin mediatik dinamik të Zvicrës.⁷⁰

65 Autoriteti i Transmetimeve i Irlandës (Broadcasting Authority of Ireland – BAI). (2023). *Raporti vjetor 2022–2023*. https://cdn.epra.org/organisations/second_documents/18/original/BAI-Annual-Report-2022_2023-Final-New.pdf?1723541589

66 Coimisiún na Meán (CNAM). (2024, nëntor). *Politika mbi pronësinë dhe kontrollin*.

67 Shih më tepër tek <https://www.cnam.ie/coimisiun-na-mean-launches-applications-for-new-journalism-schemes>.

68 See more at https://www.cnam.ie/app/uploads/2023/10/SV4_Round51_Open-Round-Guide-TV_v.Final_ENG_PC-1.pdf.

69 Shih më tepër tek <https://www.bakom.admin.ch/en/media-monitor-switzerland>.

70 Shih më tepër tek <https://www.bakom.admin.ch/en/studies-2>.

5.3 Çfarë na tregojnë standardet dhe qasjet e ndryshme ndaj pluralizmit mediatic

Kur merren së bashku, këto praktika europiane mund të integrohen në një sistem të qëndrueshëm monitorimi për një rregullim më efektiv dhe të orientuar drejt pluralizmit. Në vend që pronësinë, konkurrencën dhe mbështetjen në interes publik t'i trajtojmë si debate të ndara, ato mund të ndërthuren në një qasje të unifikuar, të gatshme për rregullatorët: një kolonë transparence për të gjitha mediat, teste pluralizmi që mund të operacionalizohen, dhe mbështetje të synuar aty ku tregjet dështojnë.⁷¹

Shtylla e parë është ajo transparencës. Një regjistër i vetëm publik që mbulon transmetimet, shtypin dhe median online (me pronarët përfitues të verifikuar dhe regjistrimin e të ardhurave nga reklammat shtetërore) është shumë më tepër se një kërkesë e plotësuar. Ai redukton asimetritë e informacionit pas së cilave fshihen kapja politike dhe financimi okult. Kur regjistrimet përditësohen dhe vendosen në baza të detyrueshme, rregullatorëve nuk u duhet të marrin me mend se kush kontrollon çfarë; gazetarët dhe studiuesit mund të ndjekin ndikimin në platformat e shumta; pronarët e reklamave dhe institucionet publike mund të verifikojnë konfliktet e interesit para se të shpenzojnë; dhe publiku mund të dijë kush qëndron pas lajmeve që konsumon. Lejimi i aksesit në licenca, kapacitetin e multipleksit, dukshmërinë në ekran dhe kushtëzimi i fondeve publike me deklaramë të sakta e ndryshon situatën dhe e bën transparencën “çmimin e hyrjes”, jo një kriter opsional.

Shtylla e dytë përbëhet nga testet e pluralizmit: tregues objektivë që trajtojnë shqetësimet për “fuqi të tepërt” nëpërmjet vendimeve racionale. Kur të dhënat mbi audiencën janë të forta, vendosja e taveve për pjesën e audiencës lehtëson identifikimin e dominancave dhe pamundëson kontestimin e tyre. Mbatja e llogarive financiare sipas metodologjive të përmirësuara, përqindja që zënë të ardhurat nga mediat ndërsektoriale tregojnë fuqinë e konglomerateve që mund t'u shpëtojnë rregullave kur ato janë të ndara për televizionin ose shtypin. Testi i licencimit/bashkimit mban pluralizmin në vëmendje kur pronësia ndryshon, ndërsa një indikator që kombinon anketa, mbulim dhe përqendrim gjurmon fuqinë formësuese të opinionit në TV, radio, shtyp, media online dhe media sociale. Të përdorura së bashku, këto mjete ndajnë ndikimin nga zhurma, identifikojnë rreziqet që herët në proces dhe justifikojnë masa proporcionale që mund të shkojnë nga angazhimet për ndryshimin e qasjes dhe krijimin e dritareve programore për të tretët deri te shitjet e aksioneve në rastet ekstreme. Për më tepër, ato krijojnë një cikël mësimi: çdo vlerësim përmirëson të dhënat, të cilat përmirësojnë vendimin e ardhshëm.

Shtylla e tretë është mbështetja aty ku tregjet dështojnë. Edhe me transparencë të plotë dhe teste të forta, disa forma të gazetarisë, përfshirë raportimin lokal, përmbajtjet në gjuhë minoritare, investigimet, mbulimin e gjykatave dhe të demokracisë vendore, mbeten strukturalisht të pa financuara mjaftueshëm. Për të mbuluar këto boshllëqe, mund të krijohen fonde për mediat me interes publik. Lidhja e përfitimit nga këto fonde me përditësimin e deklaramëve të pronësisë dhe raportimin e reklamave shtetërore ofron një stimul më të fortë: mediat që respektojnë rregullat marrin mbështetje, ndërsa ato që nuk i respektojnë, nuk kanë të drejtë të përfitojnë. Me kalimin e kohës, kjo krijon informacion bazë më të saktë në zonat dhe komunitetet që nuk paraqesin interes ekonomik, duke forcuar kulturën e transparencës që vendoset nga shtylla e parë.

⁷¹ Duke u bazuar në këto modele dhe si pjesë e punës së tij të orientuar drejt politikave, Qendra për Kërkime në Media dhe Gazetari ka zhvilluar një model të gjithanshëm monitorimi dhe rregullimi për të forcuar transparencën dhe pluralizmin në ekosistemin mediatic. Ky punim është ende në proces dhe pritet të publikohet në janar 2026.

Shembuj nga e gjithë Europa tregojnë se si këto shtylla mund të përdoren në praktikë. Pragjet e pjesës së audiencës në Gjermani, kombinimi i kufizimeve strukturore dhe mbikëqyrjes së përmbajtjes në Francë, treguesi ndërmedial SIC në Itali, lidhja e transparencës së pronësisë me aksesin në fondet e gazetarisë në Irlandë, ose monitori i fuqisë formësuese të opinionit në Zvicër, të gjitha demonstrojnë modele funksionale. Këta shembuj u përzgjedhën sepse përfaqësojnë qasje të konsoliduara dhe të menduara mirë për rregullimin e medias; megjithatë, ata nuk janë të vetmit. Modele të tjera, qoftë në zhvillim ose të përshtatura për specifikat kombëtare, mund dhe duhet të merren parasysh, duke reflektuar diversitetin e traditave rregullatore dhe kapaciteteve institucionale në Europë.

Elementët e secilës shtyllë mund të kombinohen në një qasje tërësore dhe kohezive ndaj pluralizmit dhe transparencës mediatike, duke shërbyer si për qëllime rregullatore, ashtu edhe për qëllimin e edukimit të publikut në fushën e medias. Thelbi është integrimi i këtyre elementëve në një kornizë të vetme dhe më pas përshtatja e saj me kontekstet dhe nevojat lokale. Një sistem i tillë do t'i pajiste rregullatorët me të dhënat dhe autoritetin për të marrë vendime të informuara dhe proporcionale për mbrojtjen e pluralizmit mediatik.

6. Rekomandime

Duke u bazuar në intervistat me aktorët kyç të realizuara për këtë raport dhe duke u mbështetur në gjetjet e një studimi të mëparshëm të fokusuar në reformën e medias në Shqipëri,⁷² autori propozon një sërë rekomandimesh të fokusuara në transparencën dhe pluralizmin mediatik. Ato pasqyrojnë si këndvështrimet lokale, ashtu edhe standardet europiane, veçanërisht ato të përcaktuara në Aktin European për Lirinë e Medias (EMFA) dhe nga Këshilli i Europës.

6.1 Transparenca e pronësisë (ligjore)

Aktorët kyç theksuan në mënyrë të përsëritur se mungesa e transparencës së pronësisë lejon që mediat të përdoren për pazare nga elitat e biznesit me interesa politike dhe ekonomike. Rregullat aktuale për deklarimet në Shqipëri zbatohen vetëm për shërbimet audiovizive, duke lënë jashtë mbulimit mediat e shkruara dhe ato online. Për t'u harmonizuar me EMFA-në, detyrimet e transparencës duhet të përfshijnë të gjitha shërbimet mediatike, të cilat duhet të bëjnë publike:

- Pronësinë ligjore dhe përfituesit e vërtetë, përfshirë anëtarët e ngushtë të familjes dhe përfaqësuesit (në përputhje me masat e mbrojtjes së privatësisë);
- Lidhjet me kontratat shtetërore, koncesionet dhe statusin e investitorit strategjik;
- Raportet financiare vjetore, përfshirë financimin publik.

Masat legjislative duhet të krijojnë një kornizë transparente dhe neutrale për mediat, e cila do të konsolidojë detyrimet për deklarim në të gjithë sektorët mediatikë. Në vend që të vendosë një sistem të detyrueshëm licencimi ose regjistrimi, një kornizë e tillë duhet të mundësojë regjistrimin publik vullnetar si instrument transparence, në përputhje me standardet e Këshillit të Europës, të cilat ndalojnë marrjen e autorizimit paraprak nga shteti për funksionimin e medias.

⁷² Dokument informues pas mbledhjes së Grupit të Punës mbi standardet evropiane lidhur me pavarësinë dhe forcimin e rregullatorit të mediave në kontekstin e Lirisë së Shprehjes, e mbajtur më 24 qershor në Tiranë (dokument i brendshëm).

Për të shmangur teprimet rregullatore, roli i Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), apo i ndonjë entiteti tjetër shtetëror, duhet të kufizohet vetëm në koordinimin dhe verifikimin e të dhënave, nën mbikëqyrje të pavarur dhe me pjesëmarrjen e shumë aktorëve, dhe të ketë funksione kontrolli ose autorizimi. Më e rëndësishmja, pavarësia e vetë AMA-s duhet të garantohet si prioritet, duke eliminuar çdo mundësi politizimi. Pa autonomi institucionale të vërtetë, mekanizmat e transparencës rrezikojnë të kapen dhe të përdoren si mjete presioni politik, në vend që të jenë instrumente llogaridhënieje.

Regjistri, që mbulon pronësinë dhe financimin publik, duhet të jetë i aftë të ndërveprojë me databazat ekzistuese të pronësisë përfituese, prokurimeve dhe koncesioneve, duke siguruar raportimin e konflikteve të interesit. Megjithatë, publikimi i të dhënave personale ose financiare duhet të jetë në përputhje me rregullat e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave, duke vendosur kërkesa proporcionale në fushën e deklarimeve. Transparenca e strukturuar në këtë mënyrë do të kufizonte ndikimin e fshehtë dhe do të përmirësonte llogaridhënien, duke respektuar njëkohësisht lirinë e shprehjes dhe privatësinë.

6.2 Masa për mbrojtjen e pluralizmit të tregut (në rrafshin e politikave)

Ekspertët e intervistuar për këtë raport theksuan gjithashtu se pluralizmi rrezikohet nga përqendrimi ekstrem i tregut në Shqipëri: transmetuesit kryesorë kontrollojnë shumicën e të ardhurave nga reklamata. Ligji ekzistues (97/2013) vendos kufizime horizontale të kufizuara, por pronësia ndërmediale mbetet e pa rregulluar, dhe Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar kufijtë mbi aksionet.

Reformat politike duhet të përqendrohen tek:

- Vlerësimet e ndikimit mbi pluralizmin për të gjitha bashkimet dhe blerjet, sipas detyrimeve të Nenit 22 të EMFA-së. Vlerësimet duhet të marrin parasysh pavarësinë editoriale, diversitetin e përmbajtjes dhe lidhjet ndërsektoriale të pronësisë.
- Përkufizimi i “pozicionit dominues” si në terma të audiencës ashtu edhe të të ardhurave, duke siguruar pragje të matshme. Për shembull, duke përdorur modele nga vende të tjera (p.sh., 30% të audiencës ose 20% të të ardhurave).
- Promovimi i pluralizmit të brendshëm kur kufizimet e jashtme janë të vështira për t’u zbatuar politikisht ose ligjërish, p.sh., kërkesa që transmetuesit dominues të demonstrojnë diversitet politik dhe kulturor në programim.
- Rregulla më të forta të licencimit duke kushtëzuar dhënien e licencave të reja me angazhime për diversitet, paanshmëri dhe transparencë.
- Mbështetje për alternativat: financim të qëndrueshëm dhe të pavarur për mediat e shërbimit publik, mbështetje për mediat komunitare dhe lokale, si dhe për mediat e pavarura investigative. Këta aktorë janë të domosdoshëm si kundërpeshë ndaj përqendrimit.

Këto masa duhet të jenë proporcionale dhe jo-diskriminuese, me mekanizma të qartë ankimi për të parandaluar zbatimin selektiv ose ndëshkues ndaj mediave kritike ose të pavarura.

7. Diskutimi mbi zbatimin

Intervistat me profesionistë të medias, anëtarë të rregullatorit dhe shoqërisë civile treguan një konsensus të fortë që reformat duhet të jenë të sekuencuara me kujdes, të kryhen në koordinim mes institucioneve dhe të monitorohen nga afër. Duke u mbështetur në këto vëzhgime, autori sugjeron një plan zbatimi me faza që kombinon reformën ligjore, forcimin institucional dhe vlerësimin rigoroz.

Faza 1: Hartimi dhe konsultimi

Aktorët theksuan se reforma duhet të fillojë të hartohet me procese gjithëpërfshirës dhe konsultim të gjerë. Hapat duhet të përfshijnë: përgatitjen e një projektligji neutral për mediat, i cili të mbulojë pronësinë, pronarët përfitues dhe financimin publik për mediat; hartimin e një akti nënligjor mbi vlerësimet e ndikimit të bashkimeve të kompanive, me sugjerime nga AMA, autoriteti i konkurrencës dhe sistemi gjyqësor; krijimin e një taskforce ndër-institucionale (AMA, Ministria e Drejtësisë, Zyra e Prokurimeve, OJQ-të, përfshirë agjencitë ndërkombëtare ku Shqipëria bën pjesë); dhe nisjen e konsultimeve të hapura me gazetarët, mediat, universitetet dhe shoqërinë civile.

Faza 2: Strukturimi institucional dhe pilotimet

Të intervistuarit thanë se mjetet praktike dhe pilotimet e hershme janë thelbësore për të ndërtuar besueshmërinë, prandaj në praktikë duhet të ndërmerren hapat e mëposhtme: zgjerimi i regjistrimit të pronësisë dhe financimit publik për mediat (përfshirë reklamat shtetërore); integrimi i tij me databazat e kompanive, koncesioneve dhe prokurimeve; krijimi i procedurave nga AMA/Ministria për identifikimin dhe regjistrimin e mediave të lajmeve online; trajnimi i gjyqësorit dhe rregullatorëve lidhur me standardet e EMFA-së, garancitë kundër shpifjes dhe metodologjinë e vlerësimit të bashkimeve; si dhe kryerja e vlerësimeve pilot të bashkimeve me mbështetje ndërkombëtare nga kolegë të fushës.

Faza 3: Intensifikimi i zbatimit

Aktorët theksuan gjithashtu se zbatimi i qëndrueshëm dhe vlerësimet e rregullta do të jenë thelbësore për të garantuar besueshmërinë: nisja e auditimeve të deklarimeve të pronësisë dhe financimit publik, duke aplikuar sanksione kur tejkalohen pragjet; kryerja e një vlerësimi të parë brenda 18 muajve, duke rregulluar pragjet, sanksionet dhe procedurat; dhe integrimi i treguesve në monitorimin e Komisionit Europian në kuadër të negociatave për Kapitullin 23.

Treguesit e zbatimit të suksesshëm:

Monitorimi duhet të lidhet me tregues të qartë dhe të matshëm. A mund të përfshijnë:

- Mbulimin: % e të gjitha mediave (transmetimet, shtypi, online) të regjistruara në regjistrin e pronësisë/financimit shtetëror
- Verifikimin: % e mediave me pronarë përfitues të verifikuar në mënyrë të pavarur
- Transparencën: Përputhshmëria me afatet dhe plotësia e deklarimeve të financimit publik (% e kontratave të publikuara në kohë)
- Garancitë gjyqësore: Koha mesatare e trajtimit të rasteve për shpifje, dëmshpërblimet mesatare të dhëna, % e padive abuzive të rrëzuara që në krye të herës
- Siguria e gazetarëve: Numri i sulmeve të regjistruara, përqindja e hetimeve të kryera
- Kontrolli i pluralizmit: Numri i vlerësimeve të ndikimit të bashkimeve të realizuara dhe të publikuara.

Përfundime: rreziqet, masat zbutëse dhe varësitë

Reformimi i kornizës së transparencës së pronësisë mediatike në Shqipëri nuk është vetëm një ushtrim teknik. Ai teston qëndrueshmërinë politike, institucionale dhe etike të sistemit të mediave në vend. Transparenca prek thelbin e interesave që kanë rrënjë të thella dhe prish marrëveshjet joformale që prej kohësh ushqejnë si patronazhin politik, ashtu edhe privilegjin ekonomik. Si rezultat, pengesa kryesore do të vijë nga rezistenca e elitave politike dhe ekonomike. Ata që përfitojnë nga mungesa e transparencës, qoftë përmes kontrollit të mediave, aksesit klientelist ndaj financimit publik (përfshirë reklamën shtetërore) apo investimeve ndërsektorale, nuk janë të gatshëm të pranojnë deklarimin e të dhënave. Kapërcimi i kësaj rezistence kërkon vullnet politik të qëndrueshëm, presion nga shoqëria civile dhe mbështetje nga partnerët europianë të Shqipërisë, të cilët kanë mundësinë që ta lidhin progresin në drejtim të transparencës me treguesit në rrafshin më të gjerë të anëtarësimit në BE.

Sfida e dytë ka të bëjë me kapacitetin teknik dhe institucional, si dhe me pavarësinë e medias. Menaxhimi i një regjistri të unifikuar për pronësinë dhe financimin publik kërkon jo vetëm qartësi ligjore, por edhe infrastrukturë të fortë të të dhënave dhe koordinim midis agjencive të përfshira. AMA ka nevojë për burime, ekspertizë dhe mjete digjitale për të verifikuar deklaratimet, ndërlidhur databazat dhe për të mirëmbajtur sistemin. Po aq e rëndësishme është pavarësia e institucioneve që monitorojnë këto databaza për të parandaluar përdorimin e tyre për qëllime politike. Vetëm mbikëqyrja transparente mund të sigurojë që mekanizmat e deklaratimeve të shërbejnë për llogaridhënie dhe jo për kontroll. Zbatimi duhet të udhëhiqet nga proporcionaliteti. Rregullat duhet të bëjnë dallimin midis grupeve të mëdha mediatike me ndikim politik ose ekonomik dhe mediave të vogla online, podcastet ose krijuesve individualë të përmbajtjes. Detyrimet e tepërta apo uniforme mund të rëndojnë pa dashje aktorët më të vegjël dhe të kufizojnë pluralizmin. Një zgjidhje praktike do të ishte fillimi i zbatimit me faza, pra detyrimet të përmbushen në mënyrë graduale, duke filluar me operatorët e mëdhenj audiovizivë dhe përfshirë më pas mediat më të vogla të shkruara dhe online, ndërkohë që sistemet vazhdojnë të konsolidohen. Kjo qasje jep mundësinë që institucionet të mësojnë në punë e sipër, siguron proporcionalitetin gjatë zbatimit dhe garanton suksesin që në fazat e hershme, pa mbingarkuar burimet.

Një rrezik tjetër qëndron në cilësinë dhe verifikimin e të dhënave. Transparenca është efektive vetëm kur informacioni i dhënë është i saktë. Nëse deklaratimet bëhen qëllimisht të paplota dhe të pasakta me synim mashtrimin, regjistri bëhet një arkiv i gjysmë të vërtetave vë vend që të jetë një instrumenti llogaridhënieje. Besueshmëria e sistemit varet nga mbikëqyrja e pavarur dhe nga pasja e një opsioni të integruar për gjurmueshmërinë e auditimeve të kryera. Bordi mbikëqyrës, me përbërje nga përfaqësues të rregullatorit, shoqërisë civile dhe ekspertëve të pavarur, mund të monitorojë integritetin e të dhënave, zbatimin e rregullave dhe të raportojë për publikun nivelet e respektimit të legjisllacionit dhe akteve nënligjore.

Reformat e transparencës ndërthuren, gjithashtu, me çështjet e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave. Ndonëse deklarimi i pronarëve përfitues është thelbësor për të nxjerrë në dritë rrejtet e ndikimit, ai duhet të trajtohet me kujdes për të shmangur shkeljen e të drejtave të privatësisë ose pengimin e investimeve të ligjshme. Duhet një qasje e balancuar, që kombinon publikimin e të dhënave të rëndësishme për llogaridhënien publike, duke mbrojtur njëkohësisht informacionin e ndjeshëm personal. Përdorimi i mekanizmave *sandbox*, ku rregullatorët dhe autoritetet e privatësisë testojnë formatet e publikimit përpara se informacioni të vihet plotësisht në dispozicion të qytetarëve, mund të ndihmojë në balancimin midis hapjes dhe mbrojtjes së të dhënave.

Një faktor tjetër i rëndësishëm është angazhimi i publikut dhe i shoqërisë civile. Transparenca është efektive vetëm kur përdoret. Gazetarët, akademikët dhe organizatat vëzhguese kanë nevojë për akses në regjistër si dhe për aftësitë e nevojshme për të interpretuar dhe analizuar të dhënat. Përfshirja e tyre siguron një kontroll të natyrshëm mbi ndikimin politik dhe inercinë burokratike. Krijimi i kanaleve formale për monitorimin nga shoqëria civile, si një vlerësim i pavarur vjetor mbi përdorimin dhe ndikimin e regjistrit, do ta bënte transparencën një proces pjesëmarrës, jo thjesht administrativ.

Së fundi, përpjekjet reformuese të Shqipërisë do të varen nga mbështetja financiare dhe teknike e qëndrueshme. Vënia në përdorim e databazave të ndërveprueshme dhe mjeteve digjitale të auditimit kërkon investime përtej buxheteve kombëtare. Në këtë pikë, asistencë teknike e financuar nga donatorët mund të luajë një rol të rëndësishëm, duke ofruar infrastrukturë softuerike, trajnim për menaxhimin dhe verifikimin e të dhënave, dhe shkëmbime për të mësuar nga kolegët e rregullatorëve europianë. Bashkëpunimi ndërkombëtar, gjithashtu, mund ta mbrojë procesin nga presionet politike afatshkurtra duke e bërë pjesë të një kornize më të gjerë të praktikave më të mira europiane.

Në përmbledhje, avancimi i transparencës së pronësisë mediatike në Shqipëri ka të bëjë po aq me qeverisjen sa edhe me informacionin. Rreziqet, rezistenca politike, kapaciteti i dobët, cilësia jo e mirë e të dhënave dhe konfliktet e privatësisë janë reale, por të menaxhueshme. Masat për të zbutur këto, përfshirë zbatimin me faza, mbikëqyrjen e pavarur, garancitë teknike dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile, janë plotësisht të realizueshme.

Përgjegjësia për përdorimin e inteligjencës artificiale

Autori respekton politikën e Qendrës për Kërkimin e Medias dhe Gazetarisë lidhur me përdorimin e inteligjencës artificiale. Ai aktualisht shërben si drejtor i Qendrës. Sipas këtyre udhëzimeve, përdorimi i mjeteve të IA për hartimin ose gjenerimin e përmbajtjes analitike është rreptësisht i ndaluar. Aplikimet e IA lejohen ekskluzivisht për korrigjimin e gramatikës dhe rafinimin e stilit. Respektivisht, Grammarly u përdor në këtë draft për të identifikuar dhe korrigjuar çështjet gjuhësore pasi analiza ishte gjeneruar plotësisht nga autori. Puna është verifikuar si krijim njerëzor përmes Human Proof Registry.